



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji | Tetor 2012

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

NË UBT FILLOI VITI I RI AKADEMIK 2012/2013

Në UBT, me një ceremoni
solemne madhështore për
studentët e nivelit bachelor...

Faqe 5



EDHE KËTË VIT BURSA JASHTË VENDIT PËRMES "ERASMUS MUNDUS"

Faqe 12

UBT KA NËNSHKRUAR MARRËVESHJE BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN E VLORËS

Në kuadër të marrëveshjeve të
shumta që i ka UBT, me universi-
tetet të shumta më prestigjioze
në Evropë dhe botë...

Faqe 11

AKADEMIA PËR NDËRMARRËSI DHE INOVACIONE

Për herë të parë në Republikën e
Kosovës, UBT, organizoi një akti-
vitet unik dhe një javorë në nivel
vendorë dhe atë ndërkombëtar...

Faqe 14-15



NGA UBT-ja DALIN EKSPERTË TË MEKATRONIKËS

Faqe 23



NË UBT, STUDENTI GJITHMONË ËSHTË I PARI

Faqe 6

STUDENTËT E UBT-së, 'UNIVERSITETIN VEROR 2012' E NDOQËN BRENDA DHE JASHTË KOSOVËS



Faqe 8-9

Editorial



Edmond Hajrizi
President i UBT-së

URIME VITI I RI AKADEMIK!

Më lejoni së pari t'ju uroj fillimin e vitit të ri akademik 2012/2013.

Falë angazhimit të të gjithë neve viti akademik që shkoi mund të konsiderohet njëri prej viteve më të suksesshme të UBT-së. Përpos që festuam 10-vjetorin e punës së suksesshme, ne kishim një rritje sasiore dhe cilësore edhe në numër të studentëve, në staf akademik, në partnerë ndërkombëtarë, në infrastrukturë, si edhe në pjesëmarrje në projektet e ndryshme hulumtuese dhe zhvillimore.

Le të vazhdojmë në këtë mënyrë, që përmes arritjeve tona cilësore të kontribuojmë edhe më tutje në rritjen e punësimit dhe zhvillimit të vendit në përgjithësi.

Suksesi i studentëve është krenaria jonë

Një staf i përgatitur mirë është parakusht për zhvillimin e ndërmarrësisë. E ndërmarrësia është shtylla kryesore e punësimit dhe zhvillimit. Kjo u pa edhe gjatë debatit të zhvilluar në Akademinë e parë për ndërmarrësi dhe inovacione në Kosovë, që UBT e organizoi këtë verë.

Një edukim cilësor krijon një staf të përgatitur mirë, i cili është parakusht për zhvillimin e projekteve të reja dhe inovative. Një shembull shumë i mirë ishte akademia për ICT si dhe ajo për Robotikë dhe Teknologji të avancuar, e cila po ashtu është organizuar verën që shkoi. Studentët e UBT-së, me përkrahjen e stafit akademik, arritën që brenda dy javëve të zhvillojnë aplikacione shumë moderne, duke i involvuar teknologjitë më të reja në të.

Një edukim i mirë i hap dyert kudo në botë

Një shembull i mirë ishte suksesi i jashtëzakonshëm i studentëve tanë që përmes projektit Erasmus Mundus por edhe projekteve të tjera për mobilitet dëshmuar aftësitë e tyre, motivimin dhe suksesin e tyre përgjatë studimeve atje. Kjo na bën të ndihemi krenarë kudo që jemi e sidomos kur ne takohemi me udhëheqjen e këtyre universiteteve, të cilat fare nuk ngurojnë të theksojnë se sa të kënaqur janë me studentët e UBT-së dhe më cilësinë e tyre.

Suksesi i tyre ka bërë që të konsiderohemi shumë seriozë dhe të jemi institucioni i vetëm privat i cili marrë pjesë aktive (ftohët) në konsorciume me universitetet më prestigjioze në Evropë dhe botë.

Natyrisht se kjo është një arritje e studentit dhe motivit të tij për të arritur sukses (Top Education for Top Students), por kjo është para së gjithash edhe një punë shumë cilësore dhe proaktive për sukses të stafit të UBT-së, i cili si zakonisht është më i mirë (Top Education With Top Professors).

Business Technology and Innovation

Këto tri fjalë janë pjesë përbërëse e filozofisë së punës së UBT-së.

Këto ditë UBT organizon edhe konferencën ndërkombëtare shkencore për Biznes, Teknologji dhe Inovacion. Kjo konferencë organizohet edhe për nder të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë së bashku edhe Universitetin e Vlorës. Me këtë dëshirojmë të theksojmë se në 100-vjetorin ne tanimë studiojmë dhe jemi pjesë aktivi e kontributit shkencor dhe akademik jo vetëm në rajon por edhe ndërkombëtarisht. Rezultatet tona shkencore në ekonomi, inxhinieri, arkitekturë, drejtësi, robotikë, menaxhment, biznes, teknologji, inovacion, tanimë janë pjesë e referencave ndërkombëtare. Pse jo ...

Në qershor të këtij viti UBT ishte partner në organizimin e Konferencës Shkencore në Tiranë të udhëhequr nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, me temën "Roli i Teknologjisë së Informacionit në zhvillimin ekonomik".

Në vitin 2013 UBT-së i është besuar të jetë organizator i konferencës së karakterit shumë të lartë shkencor IFAC - SWIIS 2013, tema kryesore e së cilës do të jetë Stabiliteti ndërkombëtar, Teknologjia dhe Kultura. Shumë specialistë të fushës nga mbarë bota do të jenë pjesë e këtij takimi shkencor në Kosovë.

UBT dhe Komuniteti

Përveç rolit të tij për krijimin e kuadrove me kompetencë të mirëfilltë profesionale, UBT ka përgjegjësinë për të ndihmuar ambientin ku edhe vet vepron. Me projekte konkrete hulumtuese dhe zhvillimore, po punohet në shumë fusha të ndryshme të jetës, në të gjitha nivelit, për të ndihmuar zhvillimin. Diaspora, prodhimet vendore, investimet e huaja, qeverisja e mirë, zhvillimi regional, hartimi i strategjive për zhvillim ekonomik, ngrija e kompetencës profesionale në fusha të ndryshme për komuna, për komunitete, për institucione shtetërore, pjesëmarrja aktive nëpunëtori dhe borde, përfaqësimi i Kosovës në institucionet shkencore dhe profesionale ndërkombëtare janë disa prej aktiviteteve që UBT po zhvillon, duke dhënë kontributin e tij të vazhdueshëm.

Urime dhe Suksese!

IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

Botues: Edmond Hajrizi

Kryeredaktore: Naile Demiri

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400

Thyerja Grafike: ELV Studio

UNIVERSITY FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY
UBT
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

10 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2011



**UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

UBT NDEROI SENATORIN BOB DOLE

Prishtinë, 25 shtator 2012-
Studentët, stafi akademik dhe administrativ i UBT-së, e përgëzojnë Senatorin Robert Joseph Bob Dole, për udhëheqjen dhe kontributin e tij të shquar dhënë për paqe dhe lirinë e shumë vendeve në botë, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës.
Personaliteti i Senatorit Robert Dole, dhe arritjet e Tij në të gjitha fushat si politike ashtu edhe shoqërore, e bëjnë atë, jo vetëm

një amerikan të ndershëm dhe të veçantë, por edhe përkrahës të sinqertë të të drejtave dhe lirive të njeriut në të gjithë botën.
Senatori Dole, është një qytetar i vërtetë i botës, e veçanërisht duhet të nderohet dhe të konsiderohet si bashkatdhetar i Kosovës.
Lidhur me këtë, UBT- Institucion lider i Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (American European University Education)

dhe Këshilli Akademik i këtij Institucioni në bashkëpunim me Shoqatën Miqtë e Amerikës, si shenjë respekti e veçon Senatorin Robert Dole, për të arriturat e tij në mbarë botën dhe i jep mirënjohje nderi: "Doctor Honoris Causa and Leadership Excellence Award", si pjesë e festimit të 100-vjetorit të lirisë dhe pavarësisë shqiptare.

Edmond Hajrizi,
Presidenti i UBT-së,



STUDENTI I UBT-së FITON BURSË PËR STUDIME TË DOKTORATËS NË ANGLI

Prishtinë, 15 shtator 2012,
" Programi i doktoratës është katër vjeçar dhe rrjedhimisht mua më duhet të qëndroj katër vite në Angli, mirëpo, natyrisht jo gjatë tërë muajve. Pas pafundmit të këtyre studimeve, do të kthehem në Kosovë dhe të vazhdoj të jap kontributin tim sado të vogël për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe avancimin e gjithëmbarshtëm të politikave ekonomike", tha Ermal Lubishtani, për gazetën "UBT News", i cili pas përfundimit të studimeve themelore në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, dhe ato nivelit Master në Staffordshire University në Mbretërinë e Bashkuar, fiton bursë nga Open Society Foundation dhe Staffordshire University, për të vijuar me studimet e doktoratës (PhD), në Universitetin Staffordshire në Business and Law School në drejtimin PhD in Economics.

raturën ekonomike, vëmendje të veçantë i është kushtuar këtyre dy fushave, por ka pak studime që i trajtojnë këto fusha në vendet e tranzicionit, prandaj ne vlerësojmë që hulumtimi ynë do të ofroj të gjetura empirike të cilat mund të përdoren nga politik bërësit dhe nga studiues tjerë", tha z. Libuhshtani.
Sipas Tij, përvoja e fituar gjatë studimeve në UBT dhe angazhimit si staf akademik, si dhe përvoja e fituar në Angli janë të rëndësishme së veçantë dhe të dyja bashkë e kompletojnë një personalitet të kohës, që mund t'ju bëj ballë sfidave të ndryshme që hasim në jetën shoqërore.

Bursën që ka fituar për këto studime sipas Lubishtanit është e mjaftueshme - ja mbulon shpenzimet e studimit, akomodimit, literaturës dhe të vizitave të ndryshme që kanë karakter shkencor të cilat organizohen jo vetëm në Mbretërisë së Bashkuar.

Lubishtani - prodekan dhe staf akademik në UBT

z. Lubishtani, pas përfundimit të studimeve Bachelor punësohet menjëherë në UBT në cilësinë e koordinatorit të programeve të Masterit, kurse pas përfundimit të studimeve Mastër angazhohet si ligjërues në disa lëndë, dhe më pas merr pozitën e prodekanit të Fakultetit Management, Business and Economics në UBT.



22 STUDENTË E UBT-së U KTHYEN NË KOSOVË

UBT është përfitues i vetëm i projektit "Erasmus Mundus", projekt i Bashkimit Evropian. Nga ky projekt, 22 studentë të këtij universiteti, fituan bursa të plota studimi për vitin akademik 2011-2012, në të gjitha nivelet e studimit si bachelor, master dhe të doktoratës, të cilët vazhduan dhe përfunduan në universitetet më prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian, dhe tash në muajin qershor dhe korrik 2012, të gjithë janë kthyer në Kosovë dhe në UBT.

Po ashtu UBT në vazhdimësi ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me këta studentë, të cilët e kanë pasur për obligim të paraqesin raport në çdo kohë për procesin e studimeve në vendet ku kanë qenë ata. Ata me një falë, edhe tash janë shumë të lumtur dhe që janë pjesë e UBT-së, dhe për mundësinë që u është dhënë për të depërtuar jashtë vendit për studime të mëtejshme. Po ashtu, shumica nga ta mezi presin të nisnin studime mëtejshme



në UBT dhe të kontribuojnë për UBT-në dhe për vendin.
E 22 studentët që u kthyen me njohuri të shumta janë: Në Universitetin Limerik në Irlandën kanë përfunduar këta studentë si Njomza Havolli, Blertë Bytyci, Egzon Dushku, Anesa Ramaxhiu, Burim Ramadani, Rineta Jash-tari, Arnisa Kryeziu, Agron Krasniqi, kurse në Universitetin City në Londër në Britani të Madhe kanë

përfunduar këta studentë si Dri-lon Zenuni, Rina Sadriu, Ndrim Idrizi, Diana Llugaxhiu, Fatlum Gerguri, Haris Haxhimehmeti, Shkurte Berisha dhe Arian Again, kurse në Universitetin Freie të Berlinit ka përfunduar Qëndresa Sopjani, Erodita Llugaxhiu, Mirsad Kosumi në Universitetin e Bukureshtit në Rumani dhe Li-rigzona Morina në Universitetin Lapenarta në Finlandë.

STUDENTI I UBT-së, VISAR KASTRATI FITON BURSË NË UNIVERSITETIN E SHEFFIELD

Prishtinë 21 shtator 2012 - Visar Kastrati, i cili studimet themelore i ka përfunduar me sukses të shkëlqyer në UBT, në Departamentin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, ditë më parë, për këtë vit të ri akademik 2012 - 2013, ka fituar bursë të plotë për vazhdimin e studimeve Master në Universitetin e Sheffieldit, i cili gjendet në Selanik të Greqisë. Bursa është ofruar nga Universiteti i Sheffield-it në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

"Pas shpalljes së thirrjes për bursa postdiplomike nga Ministria e Arsimit, për në Universitetin e Sheffieldit, kam aplikuar dhe pas vlerësimit të dokumentacionit nga Universiteti i Sheffield-it, jam përzgjedhur njeri

nga fituesit e bursës së plotë", tha Kastrati.

Ai më tej shtoi se duke studiuar në njërën nga Top Universitetet botërore do të mundësojë atij një trokitje më të lehtë në praktikat dhe zhvillimet e fundit në fushën

e teknologjisë, dhe më pas të kthehet në Kosovë që të ndaj përvojën dhe ekspertizën që ka fituar. Po ashtu ai vlerësoj se njohuritë e fituara në UBT, gjatë studimeve themelore me planprograme më bashkëkohore dhe më një staf akademik tejet të përgatitur, i dhanë mundësinë që të përfitojë një bursë të tillë mjaft të vlefshme për ngritjen e tij akademike.

Më përfundimin e këtyre studimeve, përveç njohurive mjaft të larta që do të fitoj, ai do të pajiset edhe me titullin "Master i Shkencave në Inxhinieri Software dhe Telekomunikim". Universiteti i Sheffield-it renditet i 66-ti në renditjen botërore të universiteteve dhe njohërit përbën 1% e universiteteve më të mira në botë.



NË UBT U ZHVILLUA CEREMONIA E DIPLOMIMIT 2012

Në këtë ceremoni studimet bachelor i përmbyllën 161 studentë të tre departamenteve: Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Departamenti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Departamenti për Mekatronikë.

Prishtinë, 29 korrik 2012- Në një ceremoni madhështore, organizuar në sallën

"1 Tetori" në Prishtinë, nga UBT, u zhvillua Ceremonia e Diplomimit 2012, në të cilën studimet bachelor i përmbyllën 161 studentë të tre departamenteve: Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Departamenti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Departamenti për Mekatronikë. Ceremonia u hap me antonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe vijoi me fjalën e Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Duke folur para të pranishmëve, prindër, familjarë dhe miq, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të mediejeve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë z. Hajrizi tha: "Ju dëshirojmë mirëseardhje në ceremoninë e përfundimit të studimeve dhe ceremoninë e diplomimit të studentëve të nivelit bachelor në UBT dhe atë për tre departamente: Departamentin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Departamentin për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Departamentin për Mekatronikë.

Ne jemi shumë të nderuar që ju sot jeni pjesë e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme, e cila sigurisht është një prej momenteve më të veçanta në jetën e absolventëve tanë. Kjo ceremoni është si rezultat që del nga një përkushtim i juaj disavjeçar për të studiuar dhe për të ndërtuar një dije dhe një personalitet lideri në njërën prej profesioneve të zgjedhura nga ju, me qëllim të arritjes së një cilësie më të lartë jetësore për ju dhe shoqërinë.

Nevoja për një lider profesional është kërkesë e përditshme kudo në botë, por edhe në Kosovë.

Ne po kërkojmë të zhvillojmë një personalitet, i cili është shumë i përgatitur profesionalisht, është i përkushtuar në punë, ka shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, ndërton partneritete me të tjerët, ndihmon veten dhe shoqërinë, puna e tij bazohet në fakte dhe rezultate, ka një aftësi të lartë ndërkulturore dhe interdisiplinare, por



Pamje nga fjalimi i presidentit E. Hajrizi, drejtuar studentëve dhe mysafirëve me rastin e Ceremonisë së Diplomimit 2012

ka edhe një komunikim modern të bazuar në vlerat më të larta.

Studimet në UBT kanë pasur dhe kanë pikërisht një qëllim, që bazohet në atë që thamë: ofrimin e veglave dhe aftësive të nevojshme individit për të marrë vendime racionale dhe që i garantojnë atij suksese dhe vlera që bazohen në standardet më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Detjra kryesore është që t'ia ofrojmë studentit tonë të gjitha arritjet e fundit në shkencën e menaxhimit, në ekselencën biznesore, në teknologjinë më moderne, në robotikë, në arkitekturë, në dizajn, planifikim hapësiror, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, në integrimet evropiane por edhe në kompetencën sociale.

Kjo është mundësuar falë një planprogrami modern që UBT e ka krijuar, duke u bazuar në standardet evropiane dhe amerikane të studimeve por edhe në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga tregu i punës.

Po ashtu, kjo është mundësuar edhe falë angazhimit të një stafi akademik me një eksperiencë të lartë ndërkombëtare në shkencë por edhe në aspektin profesional.

Më shumë se 300 profesorë dhe ekspertë, nga katër kontinente, nga 20 vende dhe kultura të ndryshme, nga rreth 60 e më shu-



më universitete dhe institucione partnere me renome botërore, po sjellin në UBT përvojën dhe dijen e tyre në këto programe ku ju, të nderuar absolventë, keni studiuar.

Kjo ka krijuar një ambient unik ndërkombëtar, ndërkulturore dhe interdisiplinar jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

Kjo i krijon UBT-së mundësinë të ofrojë programe dhe projekte që nuk kanë qenë më parë të pranishme në Kosovë.

Dhe natyrisht kjo ditë e sotme vjen si rezultat i punës së madhe dhe të palodhshme të gjithëve në UBT, por para së gjithash si rezultat i punës studioze dhe të palodhshme që bë të bën ju, të nderuar studentë dhe absolventë.

Me angazhimin tuaj të madh, me argumentet e shumta të paraqitura për nivelin e zhvillimit të UBT-së, mbështetur në programet dhe rezultatet studimore, duke u anëtarësuar në shumë mekanizma ndërkombëtarë, ju dhe UBT ia keni dalë të thyeni bllokadën dhe pengesat e shumta, duke u shndërruar në ambasadorë të vendit tonë, për prezantimin e vlerave ekzistuese dhe synimeve të vendit

tonë për të përfunduar trendet më bashkëkohore të zhvillimeve në shkencë e teknologji, duke bindur dhe gjithë të tjerët se në Kosovë ka vlera që duhen çmuar e përkrahur dhe duke dëshmuar njëkohësisht se studentët dhe ekspertët kosovarë mund të përfaqësohen denjësisht në të gjitha rrethet kulminante shkencore botërore.

Me këtë ju po ndihmoni vetveten por njëkohësisht po ngrini vlerat dhe cilësinë e jetës në vend.

Dhe ju të gjithë sot meritoni një respekt të veçantë dhe një falënderim të posaçëm".



Me rastin e Ceremonisë së Diplomimit 2012, një fjalim përshëndetës mbajti edhe Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë, Dr. Ernst Reichel

Gjermania vazhdimisht investon në Kosovë

Me nga një fjalë rasti ceremoninë e kanë përshëndetur edhe Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë, Dr. Ernst Reichel, i cili tha: "Ju si e ardhmja e Kosovës mund të ndërtoni gjërat për së miri, me anë të edukimit akademik që keni marrë në UBT që në të ardhmen afërt lehtë mund të bëheni lider vendi", z. Reich, duke shtuar se Gjermania vazhdimisht investon në Kosovë, duke pasur parasysh se Kosova s'është një duk të ketë kufi dhe njerëzit do të lëvizin lirshëm nëpër vende tjera.

Me nga një fjalë rasti ceremoninë e kanë përshëndetur edhe Schari Zafapour, ligjërues në UBT. Ndërsa në emër të studentëve të graduar të UBT-së, ceremoninë e ka përshëndetur Lirig-zona Morina, e cila tha: "Ne emrin tim dhe kolegeve të gjenetarës sime një falënderim të veçantë e kemi për Presidentin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizin dhe për stafin akademik të UBT-së, për punën e tyre palodhshme, në ofrimin e studimeve të kualitetit të lartë, në ngritjen e një gjenerate tjetër të suksesshme në vend. Sot UBT është krenarë për të gjithë ne, e ne po i tregojmë botës që të diplomuarit e UBT-së janë specialistet më të mirë që vendi ynë e ka pasur ndonjëherë".

Pas fjalëve përshëndetëse ka vijuar ceremonia e diplomimit, me dhënien e betimit nga të porsadiplomuarit dhe me marrjen e certifikatave.

Studentët e dalluar

Po kështu, gjatë kësaj ceremonie janë shpallur edhe studentët e dalluar të tre departamenteve, të cilët janë nderuar me certifikata. Nga Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi u certifikuan këta studentë si Nora Hasani dhe Qëndresa Sopja, nga Departamenti Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri janë Besart Pllana, Besim Shala dhe Kreshnik Ismaili, Gentian Hyseni vijën nga Departamenti Menaxhment i Mekatronikës.

Studentët ambasadorë

Në këtë ceremoni u certifikuan edhe ambasadorët e UBT, të cilët janë si Halil Nallbani, Rilind Durrugaj, Kushtrim Hasani, Meriton Kabashi, Ismail Shabani, Shefki Svarqa, Leotrim Arifi, Meriton Beqaj, Jeta Zenunaj, Durim Dabiqaj, Saranda Musliu dhe Krenare Mustafa. Manifestimi është përcjellë me pika të zgjedhura muzikore, ndërsa madhësitë atij ia kanë shtuar mysafirët e shumtë, të cilët kanë madhështuar ceremoninë e diplomimit.



NË UBT FILLOI VITI I RI AKADEMIK 2012/2013

Prishtinë, 8 tetor 2012- Në UBT, me një ceremoni solemne madhështore për studentët e nivelit bachelore, më 8 tetor, është hapur viti i ri akademik 2012/2013.

Në ceremoni morën pjesë, zëvendës-presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Mo Vaziri, dhe dekanët e njësisë akademike, profesorët, studentët e rinj si dhe familjarët e tyre.

Zëvendës-presidenti i UBT-se, Prof. Dr. Mo Vaziri, u ka dëshiruar mirëseardhje studentëve

te rinj në botën akademike universitare, duke shprehur bindjen se ata që nga dita e parë do të angazhohen me intensitet të plotë për të nxënë dijet e reja, rrugë në të cilën UBT do t'i ndihmojë me të gjitha kapacitetet e tij. Me këtë rast zëvendës-presidenti i UBT-së, z.Vaziri i ka prezantuar të arriturat dhe planet për të ardhmen e këtij institucioni duke e cekur ngritjen e UBT-së në të gjitha sektorët e veçanërisht atë të cilësisë në studime dhe krijimin e kushteve në kampusin e ri universitar të UBT-së. Po ashtu studentëve u uroj suksese në të ardhmen dhe kërkoi nga ta dhe nga stafi akademik angazhim dhe punë konkrete. "Ne së shpejti do të fillojmë këtë vit akademik me një ndërtesë të re - high-tech, dhe do të organizojmë një Konferencë të madhe ndërkombëtare për teknologji dhe inovacione, dhe do të festojmë 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë", tha zëvendës-presidenti z. Vaziri.

Viti i dhjetë që UBT organizon ceremoni për fillimin e vitit të ri akademik

Në ceremoninë e pritisjes së studentëve të rinj me një fjalë u paraqitën edhe dekanët e të gjitha Fakulteteve të UBT-së. Ata përkujtuuan se në këtë vit të ri akademik 2012/2013, është viti i dhjetë që UBT organizon ceremoni për fillimin e vitit të ri akademik. Me pas cekën se në UBT ka rritje të programeve akademike dhe po ashtu për studimet në këto njësi janë përcaktuar një numër i madh i studenteve të rinj krahasuar me



Pamje nga fjalimi i zëvendës-presidentit Mo.Vaziri, drejtuar studentëve me rastin e fillimit të vitit të ri akademik 2012/2013



vitin e kaluar, dhe me ta do punojnë një numër i madh profesorësh vendore e ndërkombëtare, eksperte të fakulteteve të përzgjedhura, ndërkohë që studentet do të kenë në dispozicion salla, kompjuter, laboratorët etj. Po kështu, si një faktor shumë pozitiv, u përmendën edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet më prestigjioze në botë dhe Evropë,

dhe lëvizjen e studentëve në këto universitete për vazhdimin e studimeve të mëtuajtshme dhe njohja e diplomave ndërkombëtarisht, dhe bashkëpunimin me kompanitë më të rëndësishme në vend dhe më gjerë, që studentëve do të mundësojnë zhvillimin në nivel sa më të mirë të punës praktike dhe punësimit të mëtuajtshëm.

Suksesi ka nisë në UBT!

Në ceremoninë e pritisjes së studentëve të rinj me një fjalë u paraqitën edhe disa studentët të dalluar të UBT-së, ku suksesi i tyre ka nisë në UBT, dhe po lulëzon ditë e më shumë. Sipas Berat Thaqit, Besmi Shala, Lena

Muhmuti, të cilët ende pa mbaruar studimet themelore në këtë institucion universitar janë punësuar në më shumë kompani më prestigjioze brenda dhe jashtë vendit, edhe më pas sot janë staf ligjërues në UBT.

Biznesmeni i njohur kosovar Selim Pacolli në emër të familjarëve tha: "Në UBT kam regjistruar fëmijën tim, sepse në këtë universitet është krijuar një ambient unik në Republikën e Kosovës, një ambient ndërkombëtar, ndërkulturorë, interdisciplinar. Siç po shihet, studimet në UBT-së kanë një qëllim, e kjo është që çdo student të jetë i përgatitur për tregun e punës". Në emër të familjarëve z. Pacolli, gjatë fjalimit të tij falënderoi Presidentin e UBT-së Prof. Dr. Edmond Hajrizin, menaxherin dhe stafin akademik të UBT-së, për punën e tyre të palodhshme në nivelin akademik, shkencorë e profesional.



INTERVISTË ME ZËVENDËSPRESIDENTIN E UBT-SË, PROF. DR. MO VAZIRI

NË UBT, STUDENTI GJITHMONË ËSHTË I PARI

"Jam entuziast për të filluar Vitin e Ri akademik 2012-2013, sikurse mijëra studentë tanë dhe stafi. Ne do të fillojmë vitin e ri akademik me një ndërtesë të re - high-tech, dhe do të organizojmë një Konferencë të madhe ndërkombëtare për teknologji dhe inovacione dhe që të festojmë 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Ne do të kemi talent të ri, staf, dhe një numër rekord studentësh. Ky do të jetë një vit i jashtëzakonshëm", tha zëvendëspresidenti për gazetën 'UBT News'

Intervistoi: N. Demiri

UBT News: A mund të na thoni diçka rreth vetës dhe angazhimeve tuaja profesionale?

Prof. Vaziri: Kam punuar në California State University - USA për 27 vite si shef i Departamentit për Kontabilitet dhe Financa, Drejtor i Qendrave për Menaxhim Global dhe Drejtor i Arrowhead Laboratory për Analiza të Sigurisë. Gjithashtu, kam shërbyer si këshilltar i Bankës Botërore dhe lider i delegacionit për Organizatën Botërore të Credit Unions. Kam ligjësuar në universitete më prestigjioze rreth botës si Francë, Gjermani, Kinë, Vjetnam etj etj. Gjithashtu kam shërbyer si president dhe CEO i Integrity Planner Inc, një kompanie me bazë në Kaliforni. Kam BS në Kontabilitet, BS në Economics, MBA në Financa, Master në Engineering, Phd në Financa Ndërkombëtare, dhe Postdoktoratë në Korporata Financiare nga universitete më prestigjioze në SHBA. Kam publikuar më shumë se 60 artikuj dhe tre libra shkencorë.

UBT News: Prof Vaziri, jeni angazhuar në pozitë mjaft të lartë dhe me përgjegjësi. Sa jeni ambientuar deri më sot me UBT dhe me politikën saj?

Prof. Vaziri: Në të vërtetë, është kënaqësi për mua të jem pjesë e ekipit fitues të UBT-së. Koncepti i kombinimit të biznesit me teknologji, dhe zhvillimi i një Universiteti Evro-amerikan është një koncept modern dhe sfidues akademik dhe ndihem shumë rehat në një strukturë të tillë.

UBT News: Prof. Vaziri, cilin sektor të UBT do ta menaxhoni dhe çka do ndryshoni në këtë drejtim?

Prof. Vaziri: Si nënkryetar për Çështje Akademike dhe Zhvillim, kam përgjegjësi të dyfishta. Si shef akademik i UBT-së, do të angazhohem në zhvillimin e vetëlerësimit rreth kurrikulës dhe cilësisë në mësimdhënies dhe standardizimin e programeve akademike. Dua të sigurohem, që ne ofrojmë programe dhe diploma të cilësisë më të lartë, të pranuar ndërkombëtarisht dhe kredibile. Plani im afatgjatë është që të gjitha programet në UBT të kenë akreditim ndërkombëtar. Arritja e ekselencës duhet të jetë esenca e çdo gjëje që bëjmë në UBT. Si zyre e zhvillimit në UBT, do të angazhohem që të ofroj të ashtuquajturin mësim gjatë tërë jetës dhe certifikata profesionale. Qëllimi im është që t'i ofroj UBT-



së ekspertizë për pesë qendrat e zgjerimit, dhe t'i ofroj atyre mësim nga distance, kurse interaktive dhe seminare, dhe të sigurohem që ato të jenë të lidhura në mënyrë efektive me kampusin kryesor të UBT-së. Dua që UBT-në ta ndajmë së bashku me të gjitha komunitetet e Kosovës si dhe tërë regjionin.

UBT-ja lojtari kryesor në zhvillimin e Kosovës

UBT News: Profesor Vaziri, çfarë ju ka motivuar të vini në Kosovë, pikërisht në UBT, dhe ta menaxhoni sektorin e cekur më lartë?

Prof. Vaziri: Kosova është shteti i ri në Evropë dhe njerëzit e Kosovës janë evropianët e rinj. Edhe pse Kosova ka shumë sfida, por kur ka sfida, ka edhe mundësi. Mundësia që të kontribuojmë në rritjen e edukimit të lartë, përmirësimin e komunitetit të biznesit, krijimi e fuqisë punëtore të shkolluar. Dua

që UBT-ja të bëhet lojtari kryesor në zhvillimin e Kosovës dhe të shërbejë te Qendra për Biznes, Inovacion, Teknologji dhe Zhvillim. Ne do t'ia dedikojmë të gjithë kampusin e ri (Instituti për Transfer të Teknologjisë dhe Inovacione - ITTI) që të sjellim teknologji në Kosovë dhe t'i ndihmojmë dhe mbështesim ndërmarrësit lokal që të rrisin standardin ekonomik në regjion dhe të sigurohem që të diplomuarit tanë të kontribuojnë në këtë zhvillim.

UBT News: Profesor Vaziri, ju keni përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe në menaxhimin e institucioneve arsimore, në vendin tuaj edhe nëpër vende tjera, a mund të krahasosh arsimin e lartë privatë dhe menaxhimin atje dhe këtu në Kosovë pikërisht UBT-në?

Prof. Vaziri: Edukimi i lartë privat është suplementar dhe pjesë e domosdoshme e shkollave publike, në secilin shtet. Për

shembull në Francë, shkollat e biznesit nuk mund të lulëzojnë pa zhvillimin e institutëve private të sponsoruara nga Oda Ekonomike. Fleksibiliteti i rekrutimit dhe zhvillimi i kurrikulës dhe investimet në kompjuterë të avancuar dhe pajisje laboratorike, janë një avantazh tjetër i UBT-së. Në SHBA, institucionet private siç janë: Harvard, MIT, Stanford, janë vetëm disa shembuj të suksesit të institucion të suksesshëm private.

UBT News: Po tingëllojnë disa zëra se keni bërë disa projekte mjaft të mëdha për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit akademik dhe administrativ në UBT, cilat janë, sa janë të përshatshme dhe sa keni gjet përkrahje nga Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi për implementimin e tyre?

Prof. Vaziri: Unë jam pjesë e ekipit të UBT-së dhe si ekip nën-lidershipin e President Hajrizit, ne do t'i rishikojmë, trisim dhe modernizojmë kurrikulen e UBT-së,

pajisjet, t'i zgjerojmë shërbimet në zyrat regionale, njohe ndërkombëtare dhe standard të ekselencës në mësimdhënie, kërkime dhe shërbime ndaj komunitetit. Ne do ta ndërkombëtarizojmë universitetin dhe zhvillojmë partnership ndërkombëtare me universitete në SHBA, Evropë, Amerikën Latine dhe Azi. Ne do shkëmbejmë student dhe ofrojmë programe ndërkombëtare me aplikim regional tek studentët tanë.

Vitet më të mira të UBT-së janë përpara

UBT News: Si e shihni të ardhmen e UBT-së?

Prof. Vaziri: Në UBT, ne kemi një ekip fitues i cili përfshin Presidentin Hajrizi, staf të dalluar që punon shumë dhe mbështetë studentët e talentuar. Me një përbërje të tillë dhe lidhshirë unë shoh një të ardhme brilante dhe fantastike të UBT-së, dhe me standarde akademike, dhe t'i shërbejë komunitetit në kërkimin e ekselencës në krejt çfarë ne bëjmë. Vitet më të mira të UBT-së janë përpara.

UBT News: z. Vaziri, sa jeni përgatitë për fillimin e vitit të ri akademik 2012/2013?

Prof. Vaziri: Jam entuziast për të filluar vitin e ri akademik 2012-2013, sikurse mijëra studentë tanë dhe stafi. Ne do të fillojmë vitin e ri akademik me një ndërtesë të re - high-tech, dhe do të organizojmë një Konferencë të madhe ndërkombëtare për teknologji dhe inovacione, dhe që të festojmë 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Ne do të kemi talent të ri, staf, me një numër rekord studentësh. Ky do të jetë një vit i jashtëzakonshëm

UBT News: Mesazh i Juaj për studentët e rinj?

Prof. Vaziri: Ne UBT, studentit gjithmonë është i pari, në edukim, këshillime, mentorim dhe planifikim të karrierës dhe rritjes personale. Prioritetit ynë i parë është që t'i shërbejmë studentëve, Presidenti Hajrizi më ka kërkuar që të përfshihem në mësimdhënie si dhe në administrim dhe hulumtim, kështu që unë do të kem kontakte me studentët. Do të doja të përfshihesha me organizatat studentore dhe të marrë pjesë në aktivitetet studentore. Dera e zyrës ime është gjithmonë e hapur për sugjerime nga studentët, komente dhe diskutime. Njerëzit nga Prishtina kane treguar miku prijte të madhe dhe shpresoj që studentët të më lejojnë që unë të jem pjesë e rrugës së tyre të suksesit në UBT.

JAVA E ROBOTIKËS NË UBT

"Pjesëmarrësit për një javë radhazi dhe me një orar të ngjeshur kanë marrë aftësi të shumta rreth zhvillimeve më të fundit në fushën e robotikës dhe në teknologjinë e avancuar, duke u nisur nga ato teorike, dhe praktike si dhe metodat e programimit në robotikë", ka thënë Presidenti i Universitetit UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.



Prishtinë 13 korrik 2012 - Në UBT është organizuar aktiviteti njëjavor me temën "Java e robotikës", i cili ka pasur karakter të lartë shkencor dhe ndërkombëtar nga fusha e reobotikës dhe e teknologjisë më të avancuar.

Përveç studentëve të UBT-së, aktivitetet e shumta të kësaj jave më përpikëri i kanë përcjellë edhe 30 nxënës nga Qendra për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale – ENCOMPASS, nga Projektit ATOMI.

"Pjesëmarrësit për një javë radhazi dhe me një orar të ngjeshur kanë marrë aftësi të shumta rreth zhvillimeve më të fundit në fushën e robotikës dhe në teknologjinë e avancuar, duke u nisur nga ato teorike, dhe praktike si dhe metodat e programimit në robotikë", ka thënë Presidenti i Universitetit UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Kurse koordinatori i aktivitetit në fjalë Dr. Muzafer Shala, ka deklaruar se pjesëmarrësit një pjesë të aktiviteve e kanë kaluar edhe në Laboratorin e Mekatronikës të UBT-së, ku patën mundësi të shohin robotë të ndryshëm si industrialë, humanoidë, robotë Soccer, punime praktike të studentëve të UBT-së, pastaj teknologjinë të kompanive të njohura botërore në fushën e automatikës si EMCO, Siemens, Festo etj.

Përshtypja e nxënësve ka qenë se ata janë të impresionuar dhe se më herët nuk kanë pasur mun-

dësi të kenë qasje në një laborator të tillë.

Të gjitha aktivitetet, e veçanërisht ligjëratat janë zhvilluar nga profesorët dhe njohës më të mirë nga fusha e robotikës.

Presidenti i Universitetit UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në ligjëratën e radhës të pranishmit i ka njoftuar për zhvillimet momentale në fushën e robotikës, më konkretisht ka folur rreth Intelligjencës Artificiale, llojeve të robotëve, aplikimit të tyre në industri, në automatikë dhe në fushën e domestikës.

Ndërkaq Can. Dr. Krenare Pireva, ka prezantuar teknologjinë me temën "Cloud Computing", e cila mënyrë e ofrimit të shërbimeve në cloud computing si dhe modelet e "cloud" -ave, duke u fokusuar në karakteristikat, benefitet ekonomike dhe teknike të shfrytëzimit të shërbimeve të kësaj teknologjie. Mbi të gjitha theks i veçantë i është dhënë shfrytëzimit të shërbimeve të "Cloud Computing" për universitetet, në mënyrë që nëpërmjet cloud të ngritët bashkëpunimi i studentëve nga institucione të ndryshme, të ngritët motivimi si dhe shfrytëzueshmëria maksimale e teknologjive të reja. I gjithë prezantimi në fund është ilustruar me shembuj të ndryshme duke shfrytëzuar shërbimet e ofruara nga ofruesit e mëdhenj të shërbimeve edukative.

Kurse Selman Haxhijaha, në ligjëratën e parë ka ligjëruar për



mënyrat e avancuara të komunikimit në rrjetat kompjuterike dhe internet teknologjitë, shërbimet dhe pajisjet e ndryshme, me pas ka ligjëruar për konceptet e avancuara në Cloud Computing me theks të veçantë në e-Learning. Pastaj është bërë demonstrimi i një Cloud Service si shërbime për studentë, z. Haxhijaha ligjëroi për sigurinë e informatës në Cloud si dhe kalkullimet në kriptologji.

"Siguria e informacionit" ishte tema e radhës për të cilën ligjëroi MSc. Gazmend Bajrami, me theks të veçantë ka shpjeguar për enkriptimin e informativë që njihet si procesi i transformimit të informatës bazë në informata të palxueshme për personat të paaautorizuar, Opo ashtu janë shpjeguar edhe disa metodat e enkriptimit, duke filluar nga ato klasike dhe të thjeshta deri te metodat që përdoren sot dhe që janë më komplekse.

Pas ligjëratës, nga nxënësit u kërkua që ta përdorin njëren nga

metodat e shpjeguar në ligjëratë për enkriptim në tekstin e zgjedhur, me ç'rast nxënësit treguan një interesim të lartë për detyrën e parashtruar.

Bashkëpunimi mes Qendrës për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale – ENCOMPASS dhe Universitetit UBT është nënshkruar ditë më parë në objektin e Universitetit UBT, dhe me qëllim të krijimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve në funksion të përkrahjes së Projektit ATOMI, i cili implementohet nga ENCOMPASS dhe i cili ka për qëllim identifikimin dhe përkrahjen e personave me inteligjencë të jashtëzakonshme.

Gjatë nënshkrimit u tha se UBT-ja do ta mbështesë Projektin ATOMI në të gjitha format dhe drejtimet, brenda kompetencave, mundësive dhe kapaciteteve të veta. UBT-ja përpos tjerave do t'i ofrojë Qendrës Encopass mundë-

sinë për t'i shfrytëzuar hapësirat universitare të UBT-së për aktivitetet e parapara të projektit ATOMI, siç janë testimet, trajnimet dhe takimet me nxënës, prindër dhe mësimdhënës.

Po ashtu gjatë nënshkrimit të marrëveshjes mes presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe drejtorit të ENCOMPASS u citua se UBT-ja do t'u mundësojë këtyre nxënësve qasje në të gjitha laboratorët për punë praktike, në bibliotekat elektronike, do t'u mundësojë që ta vijojnë Universitetin Veror të Teknologjisë pa pagesë, si dhe mbështetje për të përzgjedhurit nga ta, të cilët do të regjistrohen dhe do të vijojnë studimet në UBT. UBT-ja do t'u ofrojë bursë universitare një numri të caktuar të studentëve që do të regjistrohen në këtë universitet dhe të gjithë ata studentë që dëshmojnë rezultate shumë të mira në vitin e parë të studimeve, UBT-ja do t'u ofrojë mundësinë që një pjesë e studimeve t'i kryejnë në universitete të ndryshme perëndimore.

Në fund të nënshkrimit të marrëveshjes mes dyja palëve institucionale, presidenti i UBT-së Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka thënë se këto dy institucione do të bashkëpunojnë ngushtë dhe në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim të realizimit sa më efektiv dhe sa më efikas të projektit ATOMI për zbatimin e këtij memorandum.

UNIVERSITETI UBT, UNIVERSITETI I VLORËS DHE UNIVERSITETI I TIRANËS ORGANIZOJNË KONFERENCË NDËRKOMBËTARË PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës dhe Universitetin e Tiranës dhe institucione tjera akademike, më 2 dhe 3 nëntor 2012, organizojnë Konferencën Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, e cila do të mbahet duke filluar nga ora 10.00 në hotelin "Swiss Diamond", në Prishtinë dhe mund të përcillet nga të gjithë të interesuarit.

Në Konferencën Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, e cila do të mbahet me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, do të marrin pjesë rreth 160 pjesëmarrës - akademikë dhe profesionistë të fushave përkatëse, nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, si dhe akademikë nga shumë vende të ndryshme të botës.

BUSINESS - TECHNOLOGY - INNOVATION
International Conference in Business, Technology and Innovation

EMERGING INFORMATION TECHNOLOGY AND TELECOMMUNICATION SOLUTIONS
MANAGEMENT BUSINESS AND ECONOMICS
SUSTAINABLE URBAN DEVELOPMENT, ARCHITECTURE AND ENVIRONMENT
MECHATRONICS ENGINEERING AND ROBOTICS

In partnership with:
University of Vlorë
University of Tirana

November 2-3, 2012 at Swiss Diamond Hotel
Prishtina

www.ubt-uni.net

STUDENTËT E UBT-së, 'UNIVERSITETIN 2012' E ENDOQËN BRENDA DHE JASHTË

NË IRLANDË

Anesa Ramaxhiku, Agron Krasniqi, Burim Ramadani, Arnisa Kryeziu, Rineta Jashari, Njomëza Havolli, Egzon Dushku, të cilët kanë fituar bursë për vazhdimin e studimeve përmes UBT-së, përmes projektit "Erasmus Mundus", për studime njëvjeçare jashtë vendit në universitete më prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian, ku një pjesë nga ta patën fatin të bëhen pjesë e Universitetit të Limerikut, në Irlandë, si në vitin e tretë të studimeve bahcelore e disa master.

Këta studentë për hir të suksesit dhe sjelljeve të tyre të shkëlqyera edhe më tutje vazhduan dhe në përpikmëri ndoqën "Universitetin Verorë 2012" që organizoi po ky Universitet gjatë sezonit verorë.

"Studuam për një muaj në lëndë të ndryshme si: kulturën vizuale, kinematografi, jetën, letërsinë, perspektivën dhe ligjet e Irlandës, dhe në fund u pajisëm me nga një certifikatë për të gjitha lëndët që i ndoqëm", tha Agron Krasniqi për gazetën "UBT News". Ai shtoi se përvoja që kam fituar atje mendohej që t'i praktikoj edhe në jetën time të tashme, ku me plotëkuptimin e fjalës kemi marrë informacione të shumta mbi edukatën dhe procesin e punës dhe të mësimt.

Përveç studentëve të UBT-së, në këtë "SUMMER SCHOOL 2012" morrin pjesë edhe 120 studentë tjerë të gjithë nga Shtete e Bashkuara të Amerikës.



NË AUSTRI

Po ashtu Rinte Jashari, pasi përfundon Universitetin Veror 2012 në Irlandë, menjëherë udhëton për në Universitetin e Vjenës, dhe ndjek ligjëratat e programi në fjalë, dhe merr certifikatën për lëndët e ndjekura.

"Falë UBT-së që mi ka hapur shtigjet njëherë të bëhem pjesë e Universitetit të Limerikut përmes projektit të fituar "Erasmus Mundus", dhe fal punës dhe vullnetit tim, në këtë vit akademik arrita t'i ndjek dy universitete verore, dhe që nga të dyja jam pajisur me certifikatë dhe mirënjohje si student e mirë", citoi Rineta Jashari.

NË GJERMANI

Përveç meje, në këtë program kanë marr pjesë mbi 700 studentë nga vendete e ndryshme të botës si USA, Britani e Madhe....

Po ashtu përveç universitetit të cekur më lartë, në këtë rast vlen të veçojmë bashkëpunimin e UBT-së me universitetet në Republikën e Gjermanisë. Durim Dabiqaj, që ndjek studimet në Departamentin Menaxhment i Mekanitkës, Universitetin Veror 2012, e ka ndjekur në Universiteti i Freiburgut.

"Fakulteti i Mekanitkës është fakultete i vetmi në Republikën e Kosovës të bashkohet me një universitet të tjetër në Gjermani dhe me një universitet të tjetër në Evropë", citoi Durim Dabiqaj.

tin e Freiburg e ka pa të arsyeshëm se duhet të përfshihen edhe studentët të këtij universiteti", tha Durim Dabiqaj për gazetën "UBT News".

Shtytsë e madhe për pranimitim ka qenë edhe nota mesatare dhe njohja e gjuhës angleze të cilën e flas dhe shkruaj shkëlqyeshëm, tha ai.

"Kam arritur të fitoj njohuri të shumta nga kultura dhe historia gjermane, mbi ekonominë dhe industrinë e këtij shteti, të përfundoj me sukses nivelin A1 të gjuhës gjermane dhe jam pajisur me një certifikatë", citoi Dabiqaj.

Përveç tij, në këtë program kanë marr pjesë mbi 700 studentë nga

vendete e ndryshme të botës si USA, Kanada, Australia, Rusia, Franca, Italia, Zvicër, Britani e Madhe, Japonia, Kina, Koreja Jugore, Iran, Egjipti, Pakistan, Serbi, Kroaci, Spanje, Holanda, kurse ligjëruetit kryesisht kanë qenë nga USA, Franca dhe Gjermani dhe përveç Gjermanisë kemi shtetit edhe Zvicrën.

NË KOSOVË

Po ashtu gjatë këtij viti akademik UBT organizoi Universitetin Veror 2012, aktivitetet me karakter të lartë shkencor ndërkombëtar nga fusha shkencës dhe teknologjisë më të avancuar.

Universiteti Verorë i UBT-së, u organizua në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në UBT, stafin akademik vendor dhe ndërkombëtar dhe ekspertë, e njohës të mirë të fushës së teknologjisë, me qëllim që t'u ofrohet mbi 76 studentëve pjesëmarrës të Universitetit një program shumë prestigjioz.

"Pjesëmarrësit për tre javë radhazi dhe me një orar të ngjeshur, kanë ndjekur ligjëratat të shumta dhe u informuan rreth zhvillimeve më të fundit nga fusha e shkencës dhe e teknologjisë më të avancuar, duke u nisur nga ato teorike, dhe praktike si dhe për shumë metodat tjera", tha para të pranishmëve Presidenti i Universitetit UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë ceremonisë solemne, ku përveç studentëve e profesorëve të UBT-së, morën pjesë edhe përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, personalitete nga jeta politike vendore dhe ndërkombëtare, etj.

Njëri ndër koordinatorët e këtij aktiviteti, Fisnik Prekazi, tha se studentët mësuajnë lëndë të reja, të cilat nuk studiohen në planprogramin akademik të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, dhe përveç njohurive të shumta ata përfituan edhe eksperiencë të punës praktike ngjashme me punën provuese në kompanitë private në Kosovë. Ai me tej shtoi se, për dallim nga aktivitetet tjera të llojit të tillë që organizohen në vend dhe më gjerë, është simulimi i kompanisë dhe implementimi i sistemeve të IT-së, duke punuar studentët në departamente të veçanta.

Temat të cilat u ligjëruan në këtë program si; konceptet e avancuara në fushat e; rrjetet e avancuara kompjuterike, Implementimi i sistemeve operative në Ndërmarrje të vogla dhe të mesme, Implementimi i sigurisë në infrastrukturën e IT-së, Programim për aplikime mobile në platformat windows phone 7 dhe



VEROR KOSOVËS

android, Programimi në aplikime të uebit, sistemi i inxhinierisë, etj.

Ky aktivitet me karakter shkencor është financuar nga UBT dhe punimet e këtij aktiviteti filluan mesi i muajit korrik dhe përfunduan më 31 korrik 2012. Përveç vizitave të ndryshme, të gjitha ligjëratat u mbajtën paralelisht në hapësirat e UBT-së.

Kurse njëri ndër ligjëruesit e këtij programi Mr. Gazmend Bajrami tha se studentët kanë pas një bashkëpunim të jashtëzakonshëm, e kanë respektuar orarin dhe kanë pas interesim të madhe për të fituar njohuri të reja.

Ndërkaq, Selman Haxhijaha, njëri ndër koordinatorë e këtij aktiviteti, ka bërë me dije se ky aktivitet mëton të jetë tradicional.

“Për këtë eksperiencë të suksesshme duhet falënderuar shumë profesorët të cilët na kanë ligjëruar, të cilët gjatë gjithë kohës na kanë ndihmuar përvështrësitë ku kemi hasë”, tha Shkurte Berisha. Ajo më tej shton se, përveç ligjëratave, kemi qenë shumë të fokusuar edhe në praktikë dhe në ato momente jemi ndjerë jo si studente por si inxhinier profesionale, tha ajo.

Universitetin Veror 2012 në UBT e ndoqën këta studentë si: *Adelina Hasanmetaj, Agon Ahmeti, Alban Asllani, Alban Gërguri, Albulena Pula, Alma Shehu, Amir Asllani, Arbana Janjeva, Arbnora Heta, Ardian Ahmeti, Ariana Pavata, Bashkim Gashi, Berat Mjeku, Besart Prebreza, Besim Shala, Betim Biba, Bledar Prenku, Blerim Limani, Diana Llugaxhiu, Diellza Berisha, Dimal Stubilla, Dren Elshani, Drilon Zenuni, Egzana Peja, Emin Hyseni, Endi Hasanaj, Endrit Grajçevci, Fatlum Gërguri, Fatmir Fejzullahi, Fatmir Mehmetaj, Fatmire Bela, Faton Ferizi, Fisnik Mengjiqi, Fitim Krasniqi, Gëzim Kurshumliu, Granit Rexhepi, Haris Haxhim Mehmeti, Hasim Kozmaqi, Heroik Lusha, Imran Asllani, Kujtim Halipi, Kushtrim Ademaj, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Menxhiqi, Kushtrim Xhakolli, Lavdim Menxhiqi, Leonir Hoxha, Leutrim Panxha, Mendim Ahmeti, Mentor Kosumi, Mentor Qorri, Merita Salihu, Meriton Beqaj, Musa Kçiku, Pajtesa Gashi, Ramadan Mehmeti, Rexhep Kera, Rina Sadriu, Rrezart Prebreza, Sami Grajçevci, Saranda Azizi, Selami Misini, Shkumbim Maksuti, Shkurta Berisha, Taulant Mehmeti, Taulant Selmani, Trim Kadriu, Albert Deryjani, Albert Lekaj, Albion Xhemshiti, Albnora Hoti, Ardian Krasniqi, Behar Bulaku, Benjamin Hamzaj, Besmend Islami, Ervin Rrahmani, Fatos Rrahmani, Fitim Kacaniku, Flojere Thaqi, Florian Ahmeti, Jeton Ahmetaj, Leonita Arllati, Muhamed Retkoceri, Rrezarta Prelukaj, Shkurte Haliti, Xhelal Zharku, Dardan Thaçi, Shkurte Berisha*

STUDENTËT E UBT-së, VIZITË NË FABRIKAT PRODHUESE NË LIPJAN, KAÇANIK DHE PRIZREN

Prishtinë, 5 qershor 2012- Studentët e Departamentit të Arkitekturës në UBT, organizuan vizitë studimore në tri fabrikat prodhuese të materialeve ndërtimore si tulla dhe blloqe, si në fabrikën “Xella” në Lipjan, fabrikën “Silcapor” në Kaçanik, dhe në fabrikën “Vëllezërit e bashkuar” në Prizren, etj.

Këtë vizitë e njëkën vetëm studentët të cilët e ndjekin lëndën “Materialet ndërtimore” te Prof. Dr. Hamit Mehmeti, dhe gjithashtu vizitën e shoqëruan edhe një varg profesorësh të këtij departamenti si Prof. Dr. Fetah Jagxhiu, Dr. Binak Beqaj, Can. Dr. Muhamet Ahmeti si dhe Driton Kryeziu.

Në të gjitha fabrikat, studentët patën mundësi të shohin dhe të njoftohen drejtpërdrejt me materialet të cilat përdoren në ndërtimtari, si dhe karakteristika teknike dhe mekanike si dhe procesin teknologjik të prodhimit të këtyre materialeve, si dhe laboratorin në fabrikën “Vëllezërit e bashkuar”, i cili shqyrton materialin dhe prodhon elementeve të gatshme nga betoni.

Nga ana e profesorëve por edhe e studentëve u shtrua çështja e mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet UBT dhe fabrikave.

Palët pritisë përkrahën iniciativën dhe shprehën mikpritje edhe në të ardhmen për studentet dhe stafin e UBT-së, në këto institucione për vizita hulumtime shkencore e punë praktike.



STUDENTËT E UBT-së VIZITUAN MTI-në DHE INSTITUTIN HIDROMETROLOGJIK

Prishtinë, 01 qershor 2012- Studentët e Departamentit të Mekatronikës në UBT, gjatë këtyre ditëve zhvilluan dy vizita studimore si në Institutin Hidrometrologjik të Republikës së Kosovës, dhe u pritën nga drejtori Prof. Dr. Sylë Tahirsylaj dhe vizita e radhës ishte në Departamentin e Metrologjisë më saktësisht në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ku u pritën nga z. Zijadin Isufi dhe nga stafi i këtij departamenti.

Këtë vizitë me karakter shkencorë e organizuan si Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompu-

terike Prof. Dr. Skender Skenderi, si dhe Dr. Sc. Muzafer Shala, ligjërues në Fakultetin e Mekatronikës.

Më konkretisht studentët vizituan laboratorët e institucioneve të cekura më lartë dhe për së afërmi kanë pas mundësi të njihen me aparaturnë e cila në përgjithësi është aparaturnë nga lëmi i mekatronikës.

Palët pritisë si z. Tahirsylaja dhe z. Isufi, shprehën mikpritje edhe në të ardhmen për studentet dhe stafin e UBT-së në këto institucione për vizita e hulumtime shkencore.



Prof. Dr. Skender Skenderi ka kërkuar nga të dyja grupet e studenteve të Fakultetit të Meka-

tronikës të përgatitin nga një punim seminari rreth aparaturnë së këtyre laboratorëve.

VIZITË NË FABRIKAT PRODHUESE NË QYTETIN E FERIZAJT

Prishtinë, 1 qershor 2012- Studentët e Departamentit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi dhe ata të Departamentit të Mekatronikës në UBT, organizuan vizitë studimore në katër fabrikat prodhuese në qytetin e Ferizajt si në Fabrikën e konstruksioneve metalike “Elsam shpk”, Fabrikën e “Gypave”, Fabrikën e “Veglave” dhe Fabrikën “MECATYP KS” etj.

Këtë vizitë e ndjekin vetëm studentët të cilët e ndjekin lëndën “Temat specifike nga Menaxhmenti”, “Materialet”, “Bazat e mekatronikës” dhe “Bazat e kimisë dhe mjedisit”, të shoqëruar nga Prof. Dr. Hamit Mehmeti, prorektorë në UBT, Prof. Dr. Bajrush Bytyqi dhe Dr. Muzafer Shala.

Në të gjitha fabrikat, studentët patën mundësi të shohin drejtpërdrejt proceset e prodhimit, që nga furnizimi më lëndë të parë, përgatitja dhe prodhimi – montimi si dhe me çështjet tjera që kanë të bëjnë plasmanin e mallit – produktit, me çështjet e modernizimit të tjera.

Nga ana e profesorëve por edhe e studentëve u shtrua çështja e mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet UBT dhe fabrikave.

Palët pritisë përkrahën iniciativën dhe shprehën mikpritje edhe në të ardhmen për studentet dhe stafin e UBT-së, në këto institucione për vizita, hulumtime shkencore e punë praktike.

“Kjo vizitë ishte shumë e qëlluar dhe u krye me sukses, prandaj rekomandojmë që vizitat e tilla profesionale të organizohen dhe me grupe tjera dhe në fabrika të shumta që ka vendi dhe më gjerë”, tha Dr. Muzafer Shala.



ANKETË ME STUDENTËT E FAKULTETIT ARKITEKTURË NË UBT

SI VENDOSËT TË STUDIOINI NË UBT MË SAKTËSISHT SHKENCAT E ARKITEKTURËS?

UBT ofron kushte dhe mësim cilësor, ofron praktikën mësimore nëpër institucione brenda dhe jashtë vendit, ka një numat të madh të marrëveshjeve ndëruniversitare në botë për shkëmbimin e stafit dhe të studentëve, shumica e të diplomuarve në UBT sot janë të punësuar nëpër kompani më të mëdha në vend dhe jashtë vendit, dhe në institucione shtetërore. Këto ishin arsytet dhe qëllimet e të anketuarve tanë si dhe pse kanë vendosë të studiojnë në UBT.



Festina Mustafa

Të gjithë dëshirojmë një studim sa më të mirë dhe më cilësor për formimin e personalitetit tonë, dhe duke e parë që UBT është institucioni më i miri privatë në vend, vendosa të studioj në këtë institucion, në Fakultetin Arkitekturë. Unë dhe kolegët e mi jemi shumë të lumtur që jemi gjenerata e dytë që studiojmë në këtë fakultet.



Anduena Hundozi

Në moshë të re kam menduar edhe për shkollim universitar. Përfundova maturën me sukses të larta, dhe fillova të shikojë veb-sajtet dhe publikimet që bënin universitetet nëpër media vendore, dhe me fillim klasifikova dhe vendosa për UBT. Dhe sot jam në vitin e parë në Fakultetin Arkitekturë, dhe e kam gjetë vetën më së miri.

Valton Qerimi

Në UBT janë kushtet e mira për studime dhe stafi akademik është i nivelit më të lartë që ka ndonjë institucion arsimor në vendin tonë. Është fakulteti me ambicie shumë të mëdha për ardhmen tonë. Unë si student dua të fitoj gjithçka që është e mundur në profesionin tim nga ky fakultet që ti ndihmojë vendit tim në të ardhmen. Mendoj në të ardhmen të bëhem një arkitekt profesional, dhe UBT do mburret me kuadrin që ka shkolluar deri më tani, kuadro profesionale në profesione të ndryshme.



Kushtrim Sylja

Para se të regjistrohem në fakultet kam shikuar ueb-sajtin e UBT-

së dhe kam pa shumë ngjashmëri me universitete që janë më famë botërore. Sa i përket arkitekturës zgjedha këtë drejtim sepse arsytet ishin të mjaftueshme, pasi që kisha një lloj prirje për të dhe mundësia e përhapjes së këtij profesioni çdo ditë e më shumë në vendin tonë. Mbetem me shpresë që do të kem një të ardhme të ndritur dhe do të vazhdoj deri në fund të studimeve në UBT.



Abetare Rama

zgjedh institucionin më të mirë, UBT-në. Siç e kam vërejtur vullneti i menaxhmentit të UBT-së është për të na bërë neve sa më profesional në lëmi që po studiojmë, dhe mendoj se pas përfundimit të studimeve në UBT do të dal një arkitekte profesionale.



Në UBT të gjithë studentet janë të barabartë me njëri-tjetrin. UBT më mundëson një studim të jashtëzakonshëm për t'u bërë një arkitekte e arritur në jetë. Jam shumë e lumtur që tash e tutje jam studente në UBT.



Katarina Abazi

UBT e kam zgjedhur me dëshirë ma të madhe pasi që jam e mendimit se është më me cilësi. Arkitekturën e kam zgjedhur pasi që e dua këtë profesion dhe kam prirje në këtë drejtim, pos asaj, prindërit e mi që nga viti 1996, kanë zhvilluar biznesin privat që janë marrë me ndërtime dhe projektim. Synoj të jam një arkitekte profesionale dhe besoj se jam në drejtimin e qëlluar pasi që edhe universiteti është i qëlluar.

Anketo: Lirigzona Morina, studente e Departamentit të Arkitekturës në UBT



Alban Misini

Arsyeja pse kam vendosur të studioj në UBT, është se në këtë institucion kemi profesor të cilët na mësojnë për arkitekturën moderne të ditëve të sotshme për dallim nga universitetet tjera ku ende mësojnë me planprograme të vjetra. Një arsye tjetër dhe kryesorja është se gjithmonë ëndrra ime ka qenë të studioj jashtë vendit dhe të njihem me arkitekturën botërore dhe pastaj kam dëgjuar për projektin e fituar "Erasmus Mundus", dhe duke i marr parasysh të gjitha, dhe duke besuar në potencialin dhe aftësitë e mija intelektuale kam menduar se është një rast ideal të vazhdoj studimet edhe jashtë vendit kuptohet nëse arrija ta fitoj bursën. Sot në UBT mësohet për programe të ndryshme Archi Cad, AutoCad dhe 3DMax, për të cilat sot na u kanë lakmi studentët të cilët nuk studiojnë në UBT



Valdet Maliqi

Të jesh student i UBT-së është privilegj, duke pasur parasysh nivelin e mësimdhënësve gjatë studimeve në këtë Universitet. Kam dëgjuar dhe janë dëshmuar se nga UBT kanë dal arkitekte profesionale.



Emel Verbiqi

Pse unë kam zgjedhur UBT është se do ta gjeja vetën më së miri se gjetiu. Kam zgjedhur UBT-së sepse mendoj se ka një kualitet të mirë për studime krahasuar me tjera institucione universitare në vend që e ofrojnë këtë lëmi.

Armend Shabani

Të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet në UBT sot janë të punësuar nëpër kompani të mëdha në vend dhe jashtë vendit, po ashtu ata të cilët kanë dashur të vazhdojnë studimet jashtë vendit janë pranuar pa problem dhe sidomos nëpër universitete më të forta të botës. Dhe mendoj se pas përfundimit të studimeve themelore edhe unë do ta ndjek rrugën e tyre ose në punësim ose vazhdimin e studimeve jashtë vendit përmes UBT-së.

Elitë Sherifi

U interesova për të gjitha kurset, por në fund vendosa ta



TOP EDUCATION
FOR
TOP STUDENTS

100% EINDENLË
EOK

A PO E PENGOJNË KAMATAT E LARTA ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT?

Të anketuarit thonë se bankat komerciale që operojnë në Kosovë, i kanë kamatat me të larta në gjithë rajonin dhe në këtë mënyrë po e pamundësojnë zhvillimin ekonomik nëpërmjet sektorit privat.



Anesa Hoxha

Kamatat në Kosovë janë të papërbalueshme dhe nëse nuk behet diçka, atëherë sektori ekonomik, në përgjithësi do të mbetet i pazhvilluar. Këto norma nuk lejojnë të subjektet ekonomike t'i zgjerojnë veprimtaritë e tyre.



Egzona Islami

Mendoj se bankat në Kosovë I kanë kamatat më të larta të kredive në gjithë rajonin dhe në këtë mënyrë po e pamundësojnë zhvillimin ekonomik në vend. Duhet të bëhet diçka në këtë drejtim, përkatësisht në uljen e kamatave.



Osman Berisha

Në Kosovë, kosovarët I paguajnë kamatat më të larta të kredive në krahasim me vendet e rajonit, e kjo po e pengon zhvillimin ekonomik. Për të pasur prodhim vendor të mirëfilltë, duhen të ulen kamatat në tregun bankar.



Rrona Ahma

Mendoj se për nivelin e zhvillimit ekonomik, të cilin e ka Kosova, normat e interesit për dhënie e kredive janë shumë të larta dhe nuk lejojnë që subjektet tona ekonomike t'i zgjerojnë me tej veprimtaritë e tyre.

ANKETOI: ALOR EUJUI

UBT BASHKËPUNON ME UNIVERSITETIN E VLORËS

Prishtinë, 23 korrik 2012- Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka UBT, me universitetet të shumta më prestigjioze në Evropë dhe botë, Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe rektori i Universitetit të Vlorës, në Vlorë të Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Albert Qari, zhvilluan një takim të rëndësishëm në objektin e Universitetit të Vlorës dhe nënshkruan një marrëveshje bashkëpunim ndëruniversitar.

Më konkretisht, kjo marrëveshje parasheh mundësimin e bashkëpunim ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit, shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve, projekte të prbashketa zhvillimore dhe hulumtuese, studentët të organizojmë seminare dhe takime tjera akademike për çështje shkencor, përdorimin e bibliotekave përkatese për nevoja të studimeve dhe hulumtimeve shkencore, programe të studimit në distancë, zbatimin e përbashkët të programeve studimore, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.

Sipas palëve nënshkruese bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe Universitetit të Vlorës ka filluar edhe më herët dhe pohuan se marrëveshja është incizuar nga të dy palët, ku rektori i Universitetit të Vlorës Prof. Dr. Albert Qari, gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar qëndroi për një vizitë në Kosovë, me ftesë të Uni-



versitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) me rastin e shenimit të 10 vjetorit të punës së UBT-së.

z. Qari, gjatë kësaj vizite dhe takimit e njëpasnjëshme me Presidentin e UBT-së, Dr. Hajrizin, u njoh me zhvillimet në këtë universitet, me theks të veçantë me punën që bëhet në të gjitha

fakultete, më konkretisht, Dr. Hajrizi, e patë njoftuar atë lidhur me zhvillimet e përgjithshme për institucionin që e drejton, UBT-në, dhe kanë gjetur mirëkuptimin që në një të ardhme të afërt për të shtrirë bashkëpunimin në një varg fushash akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet, dhe

gjatë takimeve u bisedua dhe u inicua për bashkëpunimin ndëruniversitar.

Po ashtu në bazë të bisedave që patën mes udhëheqësit e institucioneve në fjalë Presidenti i UBT-së Prof. Dr. Hajrizi, u nda shume i kënaqur me të arritura ne Universitetin Vlorës.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, dy krerët e dua institucioneve universitare u dakorduan edhe për organizimin e përbashkët të konferencave të nivelit të lartë shkencor në kuadër të përvjetor jubilar, më saktësisht në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

FILLOI ERASMUS MUNDUS – SIGMA

UBT EDHE KËTË VIT OFRON BURSA JASHTË VENDIT PËRMES “ERASMUS MUNDUS”



Tetor 2012 - Në Universitetin e Varshavës në Poloni u mbajt takimi i parë për fillimin e punës së projektit të sapofitur nga Komisioni Evropian “Erasmus Mundus – SIGMA” (Critical Skills Learning for Innovation, Sustainable Growth, Mobility and Employ Ability) in the Multicultural Environment of the Western Balkans, ku UBT është pjesë e tij.

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, duke përfaqësuar UBT-në, prezantoi të arriturat, mundësitë, studime, hulumtime për institucionin të cilin e drejton.

UBT, institucioni i vetëm jopublik në Kosovë, edhe kësaj radhe është pjesë e një në konsorciumin shumë prestigjioz evropian,

ku studentët e UBT-së, përmes projektit të Komisionit Evropian në vlerë prej 3.9 milionë euro, do të kenë mundësi të studiojnë me bursa në universitete shumë prestigjioze në Evropë, si në: City University, London, Freie Universität Berlin, Lund University, Sweden, University of Milan, Italy, Warsaw University, Polonia, Warclaw Technical University, Polonia, University of Monnetpollier II, France, Twente University, Nederland.

Edhe studentët e universiteteve të lartpërmendura mund të studiojnë në UBT.

Në kuadër të projektit SIGMA janë paraparë edhe iniciativa të reja, siç janë: ofrimi i studimeve të përbashkëta, ngritja e cilësisë institucionale dhe programore, organizimi i konferencave të përbashkëta, etj.

Aplikimi për bursa do të fillojë së shpejti dhe fillimi i mobilitetit do të jetë shtatori i vitit të ardhshëm.



Është hera e dytë me radhë që UBT fiton projekt “Erasmus Mundus”, dhe deri tani është institucioni jopublik i vetmi në regjion, përfutues i këtij projekti.

Menaxhmenti i lartë i UBT-së, në këtë rast Presidenti Prof. Dr. Edmond Hajrizi, kujdes të veçantë i ka kushtuar depërimit të studentëve

nga UBT në universitetet e tjera, në të gjitha programet e studimit. Edhe në këtë pikë ka rezultuar suksesshëm, dhe UBT-ja është e vetmja prej institucioneve të arsimi të lartë privat që studentëve të vet u krijon këtë mundësi të studimit të të gjitha nivelet jashtë vendit.

Në vitin e kaluar projekti “Erasmus Mundus” ka përfshirë 16 uni-

versitete nga rajoni dhe Evropa. UBT ka qenë i vetmi universiteti privat nga Kosova dhe rajoni që ka qenë përfutues i projektit në fjalë. Ky projekt vazhdon edhe për katër vitet e ardhshme, duke ju mundësuar 22 studentëve kosovarë, më saktësisht studentëve të UBT-së bursa për të studiuar në vendet e Bashkimit Evropian.

VIZITA STUDIMORE NË NORVEGJI NË KUADËR TË PROJEKTIT AEP

UBT në vazhdimësi po merr pjesë në kuadër të një projekti të financuar nga Qeveria Norvegjeze i quajtur AEP (Academic Exchange for Progress) 2012 – 2014, i cili ka për qëllim që të kontribuojë në ngritjen e kompetencës akademike, ndërlihdjen e universiteteve me industrinë, si dhe ndërlihdjen e universiteteve norvegjeze me ato nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT).

Gjovik University College, UBT, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Evropës Juglindore janë partnerët akademik në këtë projekt. Ndërsa Shoqatat e ICT nga Kosova (STIKK), nga Shqipëria (AIDA) dhe Crimson Capital nga Maqedonia përfaqësojnë këtë projekte dhe partneritet Industrinë e ICT në vendet përkatëse. Koordinator i Projektit është Athene Projektleidelse nga Norvegjia.

Programi do të zgjatë katër vite dhe në kuadër të tij janë paraparë shumë aktivitete që mbështesin objektivat e lartpërmendura siç janë: vizita studimore, bursa për studente në të gjitha nivelet, organizimin e iventeve të përbashkëta akademike, përmirësimin e korrikulave, rritjen e praktikave të studentëve tek kompanitë e ICT.

Në kuadër të këtyre katër viteve çdo semestër do të dërgojmë një student të UBT-së me bursë në Kolegjin Universitar Gjovik në Norvegji. Po ashtu do të kemi edhe studime të doktoraturës për stafin e UBT-së në këtë institucion prestigjioz.

UBT do të përkrahët nga ky projekt edhe në shumë elemente të tjera që bëjnë të mundur ngritjen e mëtutjeshme të cilësisë në fushën akademike.



Këto ditë është organizuar vizita e parë studimore në Gjovik, ku u njohëm më për së afërmi me universitetin, programet e studimit, hulumtimet, infrastrukturën, ndërlihdjen me ekonominë, si dhe u shkëmbyem me përvoja dhe propozime për bashkëpunime të mëtutjeshme.

HAJRIZI TAKON STUDENTËT E UBT NËPËR UNIVERSITETE TË JASHTME

Gjatë vizitës në Republikën e Norvegjisë, përveç tjerave, presidenti i UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi, ka takuar edhe studentin e UBT-së, Durim Jusaj. Durimi ndryshe, dy vitet e para të studimeve i ka përfunduar në Departamentin Shkenca Kompjuterike në UBT, për vazhdimin e vitit të tretë, për vitin akademik 2012-2013, përmes UBT-së, ka fituar bursë të plotë, dhe ka nisë ligjëratat në Universitetin Gjovik në Republikën e Norvegjisë, në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, më konkretisht për specializimin e të gjitha lëndëve për programimin e lojërave.



Durimi për gazetën “UBT News”, për vizitën në fjalë tha se janë ndër krenar dhe shfrytëzova rastin e falënderova presidentin E.

Hajrizi, të cilin e kam pasur edhe profesor për dy vite me radhë, që ma dha mundësin të vazhdoj studimet në Universitetin Gjovik.

PRESIDENTI I UBT KONSULENT I BANKËS BOTËRORE PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË HULUMTIMIT DHE ZHVILLIMIT PËR INOVACION PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, është njëri prej pesë eksperteve të ftuar nga Banka Botërore për të draftuar Strategjinë për Ballkanin Perëndimor, për inovacione, e cila ka për qëllim harmonizimin e veprimeve për të ngritur aftësinë konkurruese të Ballkanit perëndimor në të cilin përfshihet: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia.

Projekti është duke u zhvilluar. Një punëtori me palët e interesit është mbajtur në muajin qershor të këtij viti në Dubrovnik, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të qeverive përkatëse, bizneseve, institucioneve akademike dhe shkencore si dhe organizatave ndërkombëtare dhe rajonale.

Përpos këtij projekti sa i përket inovacionit Prof. Dr. Edmond Hajrizi është duke punuar edhe në projektin e mbështetur nga Organizata Evropiane për Zhvillim (OECD) për hartimin e Strategjisë Nacionale të Kosovës për Inovacion.



STUDENTI I UBT-së ME BURSË TË PLOTË VAZHDON STUDIMET NË UNIVERSITETIN GJØVIK

Prishtinë, 1 tetor 2012- Durim Jusaj, i cili dy vitet e para të studimeve i ka përfunduar në Departamentin Shkenca Kompjuterike në UBT, për vazhdimin e vitit të tretë, për vitin akademik 2012-2013, ka fituar bursë të plotë, dhe ka nisë ligjëratat në Universitetin Gjøvik në Republikën e Norvegjisë, në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, më konkretisht për specializimin e të gjitha lëndëve për programimin e lojërave.

Nuk është e lehtë të depërtohet për studime jashtë vendit në universitete më prestigjioz dhe me bursa të plota studimi, por këtë mundësi studentit në fjalë dhe studentëve tjerë u ka mundësuar vetëm UBT-ja, që është i vetmi universitet privat në vend, që është përfutuese e projektit "Academic Exchange for Progress (AEP)", projekt i financuar nga Qeveria Norvegjeze, ku partneri kryesor akademik i këtij projekti është Universiteti Gjøvik.

"Studimet në UBT më dhanë mundësin të fitoj këtë bursë jashtë Kosovës dhe vet bashkëpunimi i UBT-së me universitetet dhe institucione ndërkombëtare e bën atë të jetë shumë i afërt me universitetet e tjera në rajon dhe botë dhe për mua është një privilegj dhe fat që studioj në UBT", tha Durim Jusaj, përfutuesi i bursës në fjalë.

Ai me tej shton se UBT është përfutues i vetëm i projektit "Erasmus Mundus", projekt i Bashkimit Evropian.

Nga ky projekt, 22 studentë të këtij universiteti fituan bursa të plota studimi për vitin akademik 2011-2012, në të gjitha nivelet e studimit si bachelor, master dhe të doktoratës, të cilët vazhduan dhe përfunduan në universitetet më prestigjioz të vendeve të Bashkimit Evropian, dhe tash në muajin qershor dhe korrik, që të gjithë janë kthyer në Kosovë dhe në UBT. Po ashtu edhe unë pas përfundimit të studimeve do të kthehem në Kosovë dhe do të vazhdoj studimet më tutje në UBT, dhe njohuritë e fituara do t'i shpërnda tek kolegët e mi, përfundoi Jusaj.

UBT, këtë vit dhe për tre vitet e ardhshme është përfutues i projektit Academic Exchange for Progress (AEP), i financuar nga Qeveria Norvegjeze, dhe nga ky projekt përfiton stafi akademik dhe studentët e UBT, në të gjitha nivelet e studimit.

Partneri akademik nga Norvegjia është Gjøvik University College. Ky projekt ka për qëllim avancimin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

Përveç UBT-së, në kuadër të këtij përfshihen edhe disa universitete nga rajoni, por vlen të theksohet se UBT është universiteti i vetëm privat nga Kosova dhe rajoni që është përfutuese nga ky projekt", u patë cituar në komunikatën e lëshuar për media, në prill të këtij viti.



STUDENTI I UBT-së, ME BURSË TË PLOTË PRANOHEK NË DY UNIVERSITETE EVROPIANE

Një mundësi e mirë për vazhdimin e studimeve jashtë vendit e patë edhe Argjiri Dubova, i cili vitin e parë të studimeve e ka përfunduar në UBT në Departamentin e Arkitekturës.

"Gjatë vijimit dhe në përfundim të vitit të parë akademik në UBT kam aplikuar në dy universitete jashtë vendit, në Universitetin John Cabot në Itali dhe në Hamk University of Applied Sciences në Finlandë, ku në të dy këto universitete kam arritur të shpërblehem me bursë të plotë studimi", tha për gazetën "UBT News".

Universiteti John Cabot, i ka ofruar bursë në vlerë prej 28.000- euro për vit akademik, ndërsa Hamk University of Applied Sciences, 100% bursë pa ndonjë pagesë shtesë.

Ndaj, Argjiri ka vendosur që t'i ndjek studimet në këtë të fundit, pasi që gjatë kësaj kohe iu ka nënshtruar testimit të njëjës nga ekipeve të futbollit profesional të ligës së parë në Finlandë, dhe për një periudhë të shkurtër kohore pret që të bëhet pjesë e ndonjë ekipi.

Pasi planprogramet e UBT-së, përputhen me ato të universitete të jashtme, të gjitha notat e fituara në atje mundi t'i barti në universitetin e tanishëm, tha ai.



KONFERENCËS SHKENCORE PËR MITOLOGJINË... DHE DRAMË SHQIPTARE



Prishtinë, 15 qershor 2012 – Në vazhden konferencës shkencore të studiuesve të rinj të UBT-së, dhe në kuadër të kësaj konference, është organizuara edhe videokonferenca ndërkombëtare me temën "Mitologjia, balada, legjenda dhe drama shqiptare".

Videokonferenca u organizua në dhe nga UBT në bashkëpunim Universitetit Bunkyo-Iokio të Japonisë, ndërsa organizatorët të saj ishin prof. Yuko Ikuta, nga Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Bunkyo University dhe Kreshnike Haliti në UBT, si dhe disa studentë kosovarë dhe ata japonezë të Bunkyo University.

"Mitologjia, balada, legjenda dhe drama shqiptare", ishte tema e radhës që u diskutua mes dy palëve, ku studentët e dyja institucioneve patën mundësinë e shkëmbimit për pikëpamjet e tyre mitologjike në mes të dyja vendeve. Studentët e

Bonkyo-së patën mundësinë të dinë më shumë për letërsinë tonë popullore dhe dramën.

"Të gjithë popujt e botës kanë legjenda e tyre. Po ashtu edhe shqiptarët kanë legjendat e tyre, disa në nivele më të ulëta e disa kanë arritur që të jenë edhe legjenda gjithë popullore. Legjenda gjithë popullore ndër shqiptarët janë ajo. Gjergj Elez Alia, Rozafa, Besa e Konstadinut, Ymer Agë Ulqini, tha Sumeja Zhilivoda, e cila më konkretisht foli për legjendën "Besa e Konsatdinit".

Kurse Florentina Musliu, foli për tregime të shumta për fëmijë, dhe për të dhe të pranishmit nxiti interesim të madhe tregimi "Ali Baba dhe dyzet hajdutët të ndaluar para një shpelle".

Andra Sylqe, foli për "Nitën" e Josip Relës, dhe për vepra tjera të ndryshme nga letërsia shqipe. Edhe Jeta Belallari, foli për legjendën e Rozafatit, por kjo ju referua romanit "Ura me tre harqe", të shkrimtarit tonë të njohur Ismail Kadare.

UBT ORGANIZOI AKA PËR NDËRMARRËSI DHE INOVA

Prishtinë, 02 korrik 2012 – Për herë të parë në Republikën e Kosovës, UBT, organizoi një aktivitet unik dhe një javorë në nivel vendorë dhe atë ndërkombëtar, më saktësisht "Akademisë për Ndërmarrësi dhe Inovacione".

Pjesëmarrësit për një javë radhazi dhe me një orar të ngjeshur morën aftësi të shumta dhe konceptet të ndryshme të ndërmarrësisë nga menaxhmentin strategjik dhe inovativ, për krijimin e ndërmarrjeve dhe produkteve të reja, zhvillimin e organizatave, karakteristikat e bizneseve familjare, patentat dhe françizat, gjetja e kapitalit, hartimi i biznesplaneve të frytshme dhe njohja lokale dhe globale e ndërmarrësve, tha Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Kurse prof. Engelbert Selenko, tha se ky aktivitetet një javor ka pas pwr qëllim për të ofruar pjesëmarrësve dhe ndërmarrësve të ardhshëm një program të ndërmarrësisë inovative dhe ambicioze dhe do të u mundësoj atyre të zbulojnë ide të reja për produkte, dhe poashtu do të fitojnë njohje të mirëfillta për zhvillimin e suksesshëm të tyre.

Kurse Nita Abrashi, ligjëruese në UBT dhe koordinatoreja e këtij aktiviteti tha se gjatë ligjëratave, pjesëmarrësit e akademisë punuan në grupe të vogla dhe hartonin ide të reja për produkte dhe biznese. Po ashtu, vizitat në terren u mundësoj të njohin operimet e kompanive, si dhe procesin e krijimit të tyre. Përveç tjerave gjatë Akademisë u mbajtën edhe dëgjime nga rrëfimet e disa ndërmarrësve të



suksesshëm vendorë. Morën pjesë ndërmarrës që operojnë në Kosovë, ku pjesëmarrësit e akademisë patën mundësi të dëgjojnë nisjen e suksesshëm të bizneseve të tyre.

Në biznes nuk vlen kush ka menduar por kush ka vepruar

Ligjëratë për idetë në biznes

Në ligjëratën e parë u paraqitë profesori i UBT-së, me origjinë nga Austria, prof. Engelbert Selenko, i cili më konkretisht ligjëroj për idetë në biznes, për një biznes të suksesshëm. "Për me pas një biznes të suksesshëm duhet me qenë besnik ndaj tij, i durueshëm dhe kujt po ia dedikoni". Prof Selenko, foli edhe për përvojën e tij disa vjetëshe nëpër vendet më

të zhvilluar në botë, si në Angli, Austri etj, i cili me durimin, idetë e shumta, për një kohë shumë të shkurtë të ka arrit që t'i nxjerrë disa kopani nga banktori.

Më gjerësisht foli për kompaninë që merren me prodhimin e tehametrave dhe të ngjyrave, të cilat kompani janë furnizuese e të gjitha firmave me renome si "Mercedesi" e "Honda", etj.

Ai në fund tha se në biznes nuk vlen kush ka menduar, por kush ka vepruar.

Ligjëratë për inovacionet teknologjike

Në kuadër të aktivitetit "Akademii për Ndërmarrësi dhe Inovacione", në ligjëratën e radhës u paraqitë përfaqësuesi i Organi-



zates UNICEF për Kosovë, Arbnor Hasani.

z. Hasani, ligjëroi për trendët e fundit në inovacionet teknologjike që po përdoren në zhvillimet e përgjithshëm botërore. "Duke u mbështetur në të dhënat që tregojnë se vetëm një e treta e popullsisë botërore ka qasje në internet, kurse rreth 90% kanë qasje në telefona mobil", tha ai.

z. Hasani, më tutje foli rreth rëndësisë së zhvillimit të ideve inovative që shfrytëzojnë telefonat mobil dhe SMS-in, si dhe mënyrën gjithëpërfshirëse për ndikimin e implementimit të idesë.

Më tutje, u prezantuan disa ide inovative që po implementohen në mbarë botën dhe në Kosovë, veçanërisht në lëminë e shëndetësisë duke u bazuar në teknologjitë me kod të hapur, dhe të dhënat e shumta që po gjendërohen përmes internetit dhe rrjeteve sociale. U prezantuan edhe disa shembuj të punës së Innovations Lab në Kosovë dhe se si rinia e Kosovës ka mundësi të ndikojë në implementimin e ideve me ndikim në sektorin biznesor dhe që ndikojnë në

një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Kurse, profesori i UBT-së, me origjinë nga Austria, prof. Engelbert Selenko, më konkretisht ligjëroi për mendimin kritik, ku zgjoi interesim të madh tek të pranishmit e akademisë.

Ligjëratë për pronësinë intelektuale

Drejtor i Zyrës për Pronësi Industriale në MTI, Isa Dukja, tha se të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta janë pronësi intelektuale. Sipas tij, të drejtat e autorit, janë veprat letrare, veprat muzikore, veprat koreografike, veprat e artit nga lëmi i pikturës, skulpturës dhe arkitekturës, veprat fotografike, veprat kinematografike, përkthimet dhe përpunimet e ndryshme të veprave, kurse të drejtat e përafërta janë interpretimet e artistëve, fotogramet, videogramet dhe emetimi i radios dhe televizionit. Kurse pronësi industriale, sipas Dukajt, janë patentat, marka tregtare, dizajni industrial, emërtimet e origjinës dhe topografitë e qarqeve të integruara. "Këta sektorë të cekur më lartë kanë edhe institucione mbrojtëse, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në mbarë vendet e zhvilluara: si zyra e pronësisë industriale, autoritetet doganore, sistemin gjyqësor, shërbimin policor etj. Gjithashtu këta sektorë kanë edhe infrastrukturë ligjore", ka thënë ai, duke bërë me dije se patentat është një e drejtë ligjore ekskluzive që jepet për një shpikje.

"Shpikja është një produkt ose proces që siguron një mënyrë të re për të bërë diçka ose ofron një zgjidhje të re teknike për një problem", ka thënë Dukaj. Sipas tij, shpikje është risi, shkalla e risisë dhe zbatueshmëria industriale. "Shpikësi është person, i cili me punën e vet krijuese ka bërë shpikjen. Shpikësi nuk konsiderohet personi, i cili gjatë shpikjes ka ofruar vetëm ndihmë teknike. Kurse marka tregtare është një shenjë dalluese, e cila identifikon mallra apo shërbime të ofruara nga një individ apo ndërmarrje e caktuar. Origjina e saj e ka zanafillën nga kohët e lashta, kur arti-



DEMI ACIONE

zanët riprodhuan nënshkrimet e tyre ose 'markat' në produktet e tyre artistike apo të përdorimit të përditshëm. Gjatë viteve, këto marka u zhvilluan për të arritur në sistemin e sotëm të regjistrimit e mbrojtjes. Sistemi ndihmon konsumatorët që të identifikojnë dhe blejnë një mall apo shërbim, pasi natyra dhe cilësia e tij, të treguara nga marka e tij unike, përmeshin nevojat e tyre, është shprehur Dukaj, sipas të cilit dizajni industrial është aspekti dekorativ apo estetik i një artikulli. "Dizajni mund të përbëhet nga karakteristika tridimensionale, si forma ose sipërfaqja e një artikulli, ose nga tipare dydimensionale, si motive, vija ose ngjyra", ka bërë me dije ai.

Dukaj ka folur edhe rreth shkeljes dhe pasojave të patentës. Sipas tij, kemi dy lloj shkelje e që janë e drejta materiale dhe e drejta jomateriale.

Ndërkaq profesori i UBT-së, me origjinë nga Austria, prof. Engelbert Selenko, në konkretisht ka ligjruar për kulturën, kontrollimin dhe komunikimin në biznes.

Ministri Besim Beqaj dhe Drejtori i bankës "Raiffeisen" Robert Wright,

Në ligjëratën përmblylëse të Akademisë për Ndërmarrësi dhe Inovacione janë paraqitur edhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, dhe drejtori i bankës "Raiffeisen", Robert Wright.

"Inovacioni është çelës i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe që të ketë një shtet në inovacion duhet të shkojnë 7-10 për qind e buxhetit pikërisht në sektorin e shkencës", tha ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, në një ligjëratë e zhvilluar në kuadër të akademisë.

Ministri Beqaj ka folur për hapat që Qeveria e Republikës së Kosovës i ka marrë në hartimin e një plani për zhvillim ekonomik dhe ndryshimet legjislative për të mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

"Në planin për zhvillim ekonomik të hartuar në Bullgari nuk kemi caktuar një sektor të cilët do të kenë përparësi për zhvillim pasi nuk kemi dashur që në t'ia imponojmë sektorit privat se çka të investojnë", ka thënë Beqaj, duke shtuar se tashmë plani i Banskos është duke i zbatuar. Zbatimi i tij ka nisur pikërisht me lehtësimin për të bërë biznes, eliminimin e procedurave burokratike-korruptive dhe me largimin e shtetit nga ekonomia.

"Privatizimi duhet të ndodhë, sepse është dëshmuar se shteti është menaxheri më i keq i ndër-

marrjeve publike", ka thënë Beqaj duke e arsyetuar privatizimin e Distribucionit dhe më pastaj të Ekonomisë. Beqaj ka folur në këtë ligjëratë pashmangshëm edhe për energjinë dhe Trepçën.

"Trepça është shpëtuar me miratimin e tri ligjeve, që kanë të bëjnë me AKP-në, Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe atë për Trepçën. Tashmë AKP-ja i ka të gjitha kompetencat, ndërsa Qeveria e Kosovës e ka roli kryesor në bordin e kreditorëve pasi ka investuar mbi 100 milionë euro", ka thënë ai.

Ligjëratë e ministrit ishte e përqendruar edhe në aspektin akademik për ndërmarrësi dhe inovacion, që është edhe specializimi i ministrit në fushën akademike.

Ndërkaq i drejtori i bankës "Raiffeisen", Robert Wright, më konkretisht ka ligjruar për sistemin bankar si dhe kontributin e bankës "Raiffeisen" dhënë në Kosovë në të gjitha fushat dhe shtrirjen e saj në nivel ndërkombëtar.

Vizita nëpër kompani të prodhuese

Ndryshe, punimet e kësaj akademie shkencore u përcollën edhe me disa vizita në disa kompani më të suksesshme të vendit si në "PESTOVÉ", "M-TEKNOLOGIE", "MERIDIAN" dhe furra "BUKA". Gjatë vizitës ishin të pranishëm edhe Presidenti i Universitetit UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, si dhe profesorët e UBT-së, me origjinë nga Austria, Prof. Dr. Peter Kopacek dhe Prof. Engelbert Selenko, dhe profesor tjerë vendor.

Studentët përveç mikpritjes së ngrohët nga menaxherët e lartë të kompanive në fjalë, ata për së afërmi panë prodhimin dhe u ndanë të kënaqur me të arriturat e tyre për produktin që ofrojnë në tregun vendit dhe më gjerë.

Punime e akademisë u zhvilluan për një javë me radhë, përveç vizitave të shumta nëpër kompani më profitabile të vendit, u zhvilluan edhe shumë ligjëratë shkencore nga ligjruerës edhe profesor e ekspert nga shumë vende të Evropës dhe vendorë.

Studentët të cilët e përcollën akademinë si:

Visar Prebreza, Ali Godeni, Arbër Tara, Arbresha Breznica, Arian Zenelaj, Arife Muji, Aulona Hasani, Bashkim Cerini, Blerta Gërguri, Bukurije Baftiu, Donika Sfishta, Donjetë Lika, Fadil Berjani, Mirinda Sahiti, Samire Pireva, Shamsi Ahmeti, Valdete Sopi, Partin Halimi, Albert Gashi, Berat Mustafa, Qëndresa Vasija, Ermira Shkodra, Qëndresa Thaqi, Teuta Gazideda, Erëmira Morina, Ardian Ramadani, Fadil Sadiku, Agron Krasniqi, Saranda Musliu, Anesa Ramaxhiku, Bekim Krasniqi, Fidaim Dobra, Florin Krasniqi, Genta Brestovci, Hana Janjeva, Herolinda Demolli, Libert Gashi, Lirigzona Morina, Marigona Selmani, Valmir Xhemajli, Afrim Baliqi, Pajtim Thaqi.

KAEF BASHKËPUNON ME UBT-në

Prishtinë, 7 maj 2012 - Përfaqësuesit e programit Kosovo Amerikan Education Fund (KAEF), para studentëve të UBT-së, prezantuan, ku në këtë rast e veçuan projektin për ndarjen e bursave në nivelin Master.

Gjatë prezantimit ata cekën të gjitha kriteret për marrjen e kësaj shumë si ese të shkruar dhe të përpiluar për vizionin e tyre me theks të veçantë për sektorin të cilin aplikojnë, përvoja e punës së mëhershme, disa rekomandime etj.

Siç u theksua edhe në fillim se, mënyra e vlerësimit për ndarjen e bursave nga ana e jurisë është transparente dhe ky vlerësim bëhet direkt nga ShBA.

Studentët të cilët do kenë fatin të jenë përfitues të bursave, do të studiojnë në mbi 25 universitete më prestigjioz në ShBA.

Vlen të theksohet se në vitin 2009 përfituese e bursës në fjalë ka qenë Rrezarta Veseli, ku studimet Bachelor i ka përfunduar në Fakultetin Shkencë Politike në UBT, dhe vijon studimet në shkollën Edward J. Bloustein për Planifikim dhe Politika Publike në Universitetin Rutgers, në kampusin e New Brunswick, New Jersey.



UBT BASHKËPUNON ME AGJENCINË ZHVILLIMORE RAJONALE PËR PERËNDIMIN

Prishtinë, 24 korrik 2012 - Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka UBT me institucione të shumta vendore dhe ndërkombëtare, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe drejtoresha ekzekutive, në Agjencinë Zhvillimore Rajonale për Perëndimin, znj. Lemana Hatashi, zhvilluan një takim të rëndësishëm dhe nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional.

Më konkretisht, kjo marrëveshje parasheh mundësin e bashkëpunimi ndërinstitucional si në projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese, shkëmbimin e eksperiencave nga fushat e ndryshme me qëllim të bashkëpunimit

sa më profesional, organizimin e simpoziumeve dhe konferencave ndërkombëtare, etj", theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Sipas palëve nënshkruese bashkëpunimi ndërinstitucional në mes UBT dhe Agjencinë Zhvillimore Rajonale për Perëndimin ka filluar edhe më herët dhe pohuan se marrëveshja është incizuar nga të dy palët.

Po ashtu në bazë të bisedave që patën mes udhëheqësit e institucioneve në fjalë Presidenti i UBT-së Prof. Dr. Hajrizi, u nda i kënaqur me të arritura e këtij institucioni.





Departamenti për Trajime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrante, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtimi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktëve
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatike
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAX - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informative

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vister të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Kredi për studentë



**Raiffeisen
BANK**

...JETO MË MIRË

Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
 - 10,000 Euro deri në 5 vjet
 - 0% - shpenzime administrative

www.raiffeisen-kosovo.com
Raiffeisen Direct: 038 222 222

SHTETËSIA REFUZUESE E KOSOVËS



Dr. Belul Beqaj

Lexuesve të nderuar të "Kohës Ditore" shpresoj se i kujtohet një vështrim i imi i publikuar në këtë gazetë para fillimit të luftës, ku pata shkruar se dallimi esencial politik në raport me shtetin mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe Kosovës qëndron në faktin se, shqiptarët e Kosovës për të ndëratur shtetin janë gjendje për të dhënë edhe jetën, ndërsa shqiptarët e Shqipërisë duke kërkuar jetën më të mirë janë në gjendje për të rrezikuar jetën duke braktisur shtetin ku kanë lindur. Për eksodin e postkomunizmit më parë kemi lexuar më shumë, mbahet mend veçmas ai i "Otrantos". Eksodi i madh i shqiptarëve i 6 marsit 1991 është edhe subjekti i librit «Ditar nga ferri i Brindisi», shkruar nga Giuseppe Marphionna. Ky libër mishërohet nga tregimi i ditëve

të eksodit të madh shqiptar dhe fatit mesdhetar të qytetit. Në atë kohë autori i ri në moshë, ishte kryebashkiak i qytetit të Brindisit. Subjekti i librit tregon se si papritmas autori u gjend përballë një valë njerëzish plot dhimbje, të lënduar dhe të uritur që kërkonin më parë bukë se liri. Ai shkruan: "Ndërsa i kërkoja Qeverisë kombëtare të ndërhynte me ushtri, një tjetër ushtri spontane, e përbërë nga burra, gra dhe fëmijë nga Brindisi, pa pritje pëlqimin e ndonjë autoriteti, kishte zbritur tashmë në mënyrë të pavarur në shesh për t'u ardhur në ndihmë me çdo kusht fëmijëve, grave dhe burrave të shënjuar nga vuajtja dhe uria", shkruan Giuseppe Marphionna, në parathënien e këtij libri. Besoj se pas eksodeve masive nga Shqipëria drejt 'el dorados' perëndimore dhe gatishmërisë të padiskuteshme për sakrifica nga shqiptarët e Kosovës për ta ndëratur shtetin, vlerësimi ishte - real.

Por, çfarë ndodhi ndërkohë? Në vend se të ndodhë e kundërta, shqiptarëve të Shqipërisë gjithnjë e më shumë po u bashkëngjiten edhe shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë dhe trojeve tjera etnike. Ditë më parë u dhanë dënimet e

para për trafikim të njerëzve që pësuar tragjedi në lumin Tisa. Gjykata e Prishtinës ka dënuar me 66 vjet burgim të pandehurit e përfshirë në tragjedinë në lumin Tisa, në vjeshtën e vitit 2009, ku humbën jetën 15 persona. Madje, madje ata jo vetëm që po braktisin Kosovën por edhe nuk dëshirojnë të kenë as identitetin ekzistencial dhe simbolik të Kosovës, meqë sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme në tri vitet e fundit numri i kosovarëve, të cilët kanë kërkuar heqje të shtetësisë është rritur masovisht. Vetëm në pesë mujorin e parë të këtij viti, numri total i kosovarëve, të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia, është 1.566 persona.

Këta persona, apo më mirë me thënë, këta numra, që i lexojmë sot, pas disa dekadave do të shuhjen dhe asimilohen dhe fëmijët tyre, ashtu siç janë asimiluar edhe ata, që patën braktisur vendin e origjinës në fillim të shekullit të kaluar.

Çfarë po ndodhë me shqiptarët!

Ishte deri diku e kuptueshme pse dikur braktisëm vendin nga

trysnia e pushtesve, skamja tmerruese, më vonë ikëm nga komunizmi, cenimi i drejtave, sot braktisim vendin nga pushtetarët e paafhtë që i kemi, varfëria, papunësia, humbja e shpresës së do të bëhet më mirë. Shtetndëruesit nuk u treguan të aftë t'i mbajnë njerëzit brenda. Një prind i zhgënjyer pas shqiptimit të dënimt me rastin Tisa, më tha se kjo është sikur "familjari kur nuk mund t'i ushqejë dhe mbajë fëmijët në shtëpi. Familjari, deri diku mund të arsyetohet, por pushtetarët assesit". Ata i kemi zgjedhur dhe paguhën për të krijuar kushte dhe rrethana për jetë normale e jo për ti humbur shpresat se Kosova është e sotmja dhe ardhmëria e tyre.

A jemi ne aq të paafhtë për shtet ndërtim sa që edhe ata të rinj që dje ishin të gatshëm për ta dhënë jetën për shtetin e Kosovës, sot aq shumë i kemi zhgënjyer sa që nuk dëshirojnë të kenë as lidhje simbolike të identitetit shtetëror...! A sakrifikan gjeneratat e martirëve të kombit që rinia e saj, në vend se të ndërtoj vendin e vet, të ndërtoj të ardhmen në vendet tjera, t'i drejtoj sytë jashtë vendit të origjinës...dhe nëse vazhdohet kështu çfarë kemi bërë me idealet

e atyre që dhanë jetën për shtetin e Kosovës të cilin po braktisin gjithnjë e më shumë të rinjtë! Fundja, mashtrohen rëndë idealistët e djeshëm nëse mendojnë se nuk do të japin përgjegjësi për materializmin e sotëm.

Besoj se të gjithë duhet të mendojnë mirë çfarë po bëjmë me shtetin e ri të Kosovës. Përgjegjësia më madhe natyrisht është e lidershipit politik, por edhe ne, që e kemi zgjedhë këtë lidership, pavarësisht nga manipulimet, duhet të mendojmë mirë e mirë sa po i kontribuojmë kësaj gjendje. Fatkeqësisht, fenomeni pasurimit nga politika mbetet në modë ndërsa dhe faktorizimit nga puna e ndershme jashtë mode, por Qeveritarët e sotëm kanë dëshmuar se nuk dinë të bëjnë shtet për qytetar. Ata shtetin e kanë identifikuar me pushtetin e vet. Prandaj, do të bënim mirë sikur lidershipit politik t'i heqim nga pushteti i Kosovës, sepse janë shkak i atyre 1.566 personave që e kanë heq dorë nga shtetësia e Kosovës.

(Pjesë nga libri: "(S)a mund t'ia besohet lidershipit të Kosovës", që është në procedurë të botimit)

KUR DO T'IA NISIM TË RESPEKTOJMË GJUHËN TONË

JU VARROSIN ME "BEREQET"!

...Deri atëherë, vlen të marrësh me qira një "pordhesë" (hapësirë përdhese në një ndërtesë), të hamë "specë djegse të qkymë", ta lashë veturën në një vend që emërtimin e ka "Qebaptore, Elektricit, Vullkanizer, Autolarje", të punosh "pranë" një institucioni dhe të të varrosë "Bereqeti"...

"Komuna e Gjilanit ka miratuar një vendim me të cilin heq shpenzimet për ceremonitë e varrimit, për të gjithë qytetarët e komunës. Komuna do t'i paguajë kompanisë "Bereqeti" 240 euro për çdo ceremoni mortore. Vendimi është marrë me kërkese të Bashkësisë Islame në Gjilan".

Ky është lajmi. Dhe lajm i mirë. Për një veprim që shkon në ndihmë të qytetarëve. Në ditën e vdekjes së dikujt, komuna nuk mund t'ua heq dhimbjen e mërzinë, por së paku është kujdesur që t'ua zvogëllojë telashet, madje edhe shpenzimet.

Gjithçka në rregull, do të thuhet, shembull që duhet ndjekur edhe nga komunat e tjera, të cilët së paku bëjnë diçka për qytetarët e vet. Në këtë kohë krize, familjarët e gjallë ndihen më të lehtësuar se dikush, në këtë rast pushteti, po mendon për ta, duke ua lehtësuar ceremoninë e varrimit dhe duke i kursyer në shpenzime që gjithsesi duhet të bëhen. E dihet që ka familje që mezi ngihen me bukë dhe kursimi i një pjesë të shpenzimeve për varrimin e familjarit të vdekur nuk është edhe pak.

Por, e gjithë kjo punë, në rastin e Gjilanit, ka një të metë. Në dukje e vogël. Por, meqë ka mundur të përmirohet, nuk është edhe e vogël. E kuptoni që fjala është për

emrin e kompanisë e cila ka fituar tenderin për kryerjen e ceremonive të varrimit për qytetarët që vdesin dhe varrosen në këtë qytet.

Sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, BEREQET ka këtë kuptim: 1. "Drithë; të lashtat e mbjella dhe prodhimi i tyre. Bereqet i mbarë. Farë bereqeti. Vit me bereqet. Hambarët e bereqetit. Bëj bereqet. Mbledh bereqetin. Me bereqet! Bereqetin e njeh drapri.

2. fig. Fryt, dobi; vlerë. Punë (mbledhje) pa bereqet. Fjalë pa bereqet. S'ka bereqet. Lëmë pa bereqet".

Ndërsa për diçka që është i BEREQETSHËM, Fjalori thotë kështu: "1. Që ka të korra të mbara, që ka prodhim të madh; që sjell prodhim të mbarë; Vit (mot) i bereqetshëm. Shi i bereqetshëm.

2. I frytshëm, i begatshëm. Punë e bereqetshme".

E tash, është e qartë se të vdekurit nuk janë "drithë" dhe as vdekja nuk është "punë e bereqetshme".

Gjithçka mirë me këtë nisim në Gjilan - s'ka dyshim se është për të mirën e qytetarëve - por emri i kompanisë, a mos është pak fytesh dhe objekt për humor. E së paku në rastet të tilla, si rastet e vdekjes, as fyterja nuk ka vend dhe humor, nëse janë farë familje hokatarësh,

pushon së paku për një kohë, në mos përgjithmonë.

E, jo vetëm ky rast nga Gjilani duhet të shërbejë për vetëdijimin e të gjithë atyre që shkruajnë diçka, emërojnë një institucion, komunikojnë, në çfarëdo forme, me publikun. Një shikim në mënyrën e shënimt të emrave të institucioneve shtetërore, emërtimin e kompanive të ndryshme, mbishkrimet e ndërmarjeve, tabelat e rrugëve... na bën të konstatojmë se në këtë vend, jo se nuk dinë të shkruajnë shqip, por nuk duan ta respektojnë as gjuhën tonë e as opinionin publik.

Me vite të tëra, në hyrje të kryeqytetit nga rruga e Ferizajt, në një tabelë emri ni kryeqytetit tonë është i shkruar dy herë serbisht dhe hiq në shqip. Është shkruar edhe në media për këtë, por askush nuk ka marrë mundimin që ta përmirojë këtë gabim të bereqetshëm.

Në shkresat e institucioneve të ndryshme ka plot gabime drejtpalshme, gjë që është e pafalshme. Një hulumtim i vogël na zbuloi se në plot prej këtyre institucioneve nuk ka asnjë të punësuar në detyrën e redaktorit gjuhësor në gjuhën shqipe! Veprim më pa mend nuk ka të shkojë.

Na ka rënë kohëve të fundit të shohim plot dokumente gjyqësore, kuptimi i të cilave do aftësi shitesë ose kuptim me hamendësim, sepse shumë fjali është e vështirë të deshifrohen.

Po sektori privat. Ata, dorën në zemër, edhe nuk duhet fajësuar shumë kur sheh qag gabime në ato fusha ku ato nuk do të duhet të zinin vend. Por, edhe aty ka shumë çështje për t'u kritikuar. Nëse ke para dhe ke vendosur të hapësh një biznes, është e pakuptimtë të mos harxhosh pak kohë që dokumentet e biznesit, që nga emërtimi e tutje, të jenë të shkruara mirë në gjuhën shqipe. Çka është edhe më e rëndësishme, të mos lejohen shkarje të mëdha, sidomos në emërtimin e institucionit, sepse ai duket, i vendosur në ballë të objektit.

Po bizneset prodhuese. Të gjithë gëzojemi kur dikush hap një biznes prodhues në vendin tonë. Jo vetëm se punëson njerëz, por edhe e kemi më mirë se një produkt që prodhohet këtu ia mbyll rrugën importit të një produkti nga vendet e tjera. Por (nuk do të përzihemi në çështjen e kualitetit), nëse një tike të produktit të prodhuar në vend nuk është e shkruar mirë në gjuhën shqipe, sa

blerës do të revoltohen dhe nuk do ta blejnë atë? Nëse investohet miliona euro për hapjen e një biznesi prodhues, a nuk është fyerje fakti që nuk investohet edhe pak, një shumë minimale, në mënyrë që emërtimet dhe të dhënat e një produktit të shkruhen në gjuhën shqipe?

Shembujt e mirë të deritashëm mund të numërohen shumë shpejt, madje do të meritonin edhe të shpërbleheshin për kujdesin që kanë për blerësin, të tjerët shpresojmë të vetëdijohen për rëndësinë e kësaj çështjeje. Prodhuesi nuk e njeh secilin blerës të mallit të tij. Është malli ai që e vendos komunikimin e ndërsjellë. Si të besojë të dhe të vlerësojë blerësi një prodhues, nëse ky i fundit e fyen atë me produktin e tij, gjegjësisht me mbishkrimin në atë produkt?

Deri atëherë, vlen të marrësh me qira një "pordhesë" (hapësirë përdhese në një ndërtesë), të hamë "specë djegse të qkymë", ta lashë veturën në një vend që emërtimin e ka "Qebaptore, Elektricit, Vullkanizer, Autolarje", të punosh "pranë" një institucioni dhe të të varrosë "Bereqeti"...

S.Z.

KONFERENCA SHKENCORE E STUDIUESVE TË RINJ TË UBT-së

Prishtinë, 12 qershor 2012 - UBT në bashkëpunim me të gjitha njësit akademike ka organizuar Konferencën e parë shkencore të studiuesve të rinj.

Në këtë konferencë është paraqitur një numër i madhe i studiuesve të rinj me punimet e veta profesionale shkencore-hulumtues nga lëmit e ndryshme.

Përveç studentëve të UBT, po marrin pjesë edhe profesorë dhe mysafirë dhe ekspert të lëmvive të ndryshme, jo vetëm lokal por edhe atë ndërkombëtar.

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në fjalën e tij shprehu bindjen se organizimi i kësaj konference, është një mundësi për studentët e rinj që të shkëmbejnë ide dhe eksperiencën në disiplina, tradita dhe perspektiva të ndryshme si dhe të ndërlihen me qeshjet shkencore.

"Komisioni për vlerësimin e punimeve ka vendosur se hulumtimet e prezantuara në këtë konferencë, në një të ardhme të afërt do të publikohen në revistën e Universitetit UBT", tha Dr. Petrit Shala.

Jo vetëm Leonita Arllati, e cila sot ka prezantuar hulumtimin e saj "Komunikimi me WIRELESS" dhe Shkurta Haliti me temën "Topologjia e rrjetit", por edhe studentët tjerë ndihem të privilegjuar meqë u ka dhënë mundësi të prezantojnë punime dhe të shprehin aftësitë e tyre në një ambient të mirëfillt shkencor.

Punimet e Konferencës po zhvillohen në objektin e Universitetit UBT, dhe do zgjasin deri më 16 qershor 2012, në gjashtë sesione, dhe në këto disiplina si nga ekonomia dhe biznesi, arkitekturë, juridik, kompjuterizim e mekatronikë, etj.



MINISTRJA ÇITAKU DISKUTOI ME STUDENTËT E UBT-së

Prishtinë, 18 maj 2012 - Ministria për Integrim Evropian në Qeverinë e Republikën së Kosovës, Vlora Çitaku ka marrë pjesë në debatin e organizuar në UBT, në temën "Kosova në procesin e Integritimit Evropian".

Të pranishëm në debat ishin profesorë të UBT-së, studentë dhe të interesuar të tjerë, të cilët përcollën me interesim debatin.

Ministrja Çitaku gjatë ligjëratës së sotme u fokusua në të arriturat dhe sfidat e Kosovës në procesin e integritimit evropian. Gjersa foli për politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian, ajo shpjegoi edhe vështirësitë që e kanë përcjellë BE-në këtë periudhë e fundit, qoftë me krizën financiare po ashtu edhe me migrimin ilegal si pasojë e "Pranverës Arabe".

Ajo shtoi se "Kosova nuk do të mund t'i imponohet Evropës si problem por vetëm si sukses dhe një histori e suksesi".

Gjatë ligjëratës së saj, ajo tha se në Kosovë nuk ka euro-skeptikë, se nuk ka grupe formale, qofshin politike apo shoqërore, të cilat refuzojnë, bllokujnë apo pengojnë integrimin e Kosovës në familjen evropiane.

"Kam mbështetjen e të gjitha partive opozitare pa përjashtim dhe siç kemi mundur të vini re, para pak kohësh, presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka themeluar Këshillin Kombëtar për Integrim Evropian, pjesë e së cilës janë të gjitha partitë politike, shoqëria civile, mediat, komuniteti i biznesit, komuniteti akademik, e kështu më radhë", tha ministrja Çitaku.

Ajo tha se integrimi i Kosovës në BE nuk është dhe nuk do të jetë produkt negociimi.



"Ne nuk do të mund t'ua mbushim mendjen as komisionerëve në Bruksel e as vendeve anëtare me fjalime të bukura dhe me deklarata retorike. Integrimi evropian i Kosovës nuk është proces i jashtëm, nuk është politikë e jashtme. Integrimi evropian është dinamikë e brendshme. Është një listë detyrash është një model shtet-formimi të cilën e kemi zgjedhur ne për vendin tonë. Nëse ne do të arrijmë ta ruajmë momentumin, ta mbajmë ritmin, do të mund të prodhojmë argumente për partnerët tanë dhe t'i lëmë pa argumente oponentët e integritimit evropian të Kosovës", tha Çitaku.

Ministrja Çitaku tha se Evropa e vitit 2012 përballat me shumë sfida. Sipas saj, e para është kriza financiare, e dyta është problemi i migracionit ilegal dhe këto dy

procese të cilat zhvillohen shkëputur nga konteksti i integritimit evropian të Kosovës, kanë refleksionet e tyre ndaj Kosovës.

"Studimi i Fizibilitetit është hapi i parë në rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian. Kosova ka shënuar progres në katër blloqet, (sigurimi i dokumenteve, menaxhimi i integruar i kufijve, fushën e rendit dhe ligji dhe të drejtat e minoriteteve), të cilat i kërkon Bashkimi Evropian për të marrë udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave", vlerësoi ministrja e Integritimit Evropian, Vlora Çitaku.

Ministrja Çitaku, zhvilloi dhe përgjigjën në vijim të debatit edhe në një varg pyetjesh e çështjesh të shtuara për diskutim nga pjesëmarrësit, profesorët dhe studentët e UBT-së.



MINISTRI BEDRI HAMZA DISKUTOI ME STUDENTËT E UBT-së

Prishtinë, 31 maj 2012 - Ministri i Financave në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Bedri Hamza ka marrë pjesë në debatin e organizuar në UBT, në temën "Marrëveshja Stand-By në mes FMN-së dhe Kosovës". Të pranishëm në debat ishin profesorë të UBT-së, studentë dhe të interesuar të tjerë, të cilët përcollën me interesim debatin.

Ministri Hamza u fokusua në të arriturat dhe sfidat e Kosovës në procesin financiar vendor, të hyrat buxhetore, përkatësisht financat publike. Ai shpjegoi edhe vështirësitë që e kanë përcjellë këtë sektor në periudhë e fundit.

Z. Hamza tha se, sipas vlerësimeve, rritja ekonomike ka qenë 5.3%, por ka nevojë të ketë edhe një rritje prej 7.3%. "Ne si institucion vendimmarrës kemi prioritet të ketë rritje ekonomike në sektorin privat dhe ta përkrahim këtë sektor fuqishëm", tha ai, duke shtuar se Kosova është e orientuar në investime kapitale, me një fjalë, ku ka rritje ekonomike.

Gjatë debatit të ministrit Hamza me studentët dhe pjesëmarrësit e tjerë, u theksua se Ministria e Financave ka marrëdhënie të mira me institucionet ndërkombëtare. Gjithashtu, u theksua se, sa i përket borxhit publik, shteti ynë është në nivel të kënaqshëm krahasuar me disa shtete të tjera rajon dhe me gjerë.

Nga debati gjithashtu doli se Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë institucionet kryesore kontribuuese në buxhetin e vendit dhe dy institucione që e kryejnë me shumë sukses punën e tyre.

U theksuan gjithashtu vështirësitë që dalin në drejtimin e një institucioni me ndikim të madh në vend, siç është Ministria e Financave, por falë një pune të palodhshme gjërat po shkojnë kah zhvillimi pozitiv.

Gjatë takimit me studentët dhe profesorët e UBT-së, ministri Bedri Hamza foli edhe për një varg çështjesh në interes të të pranishmëve.

PROF. GURALUMI KA LIGJËRUAR NË UBT

Prishtinë, 13 qershor 2012- Në UBT vazhdimisht ligjërata zhvillohen edhe nga personalitete dhe profesorë të fushave të ndryshme të botës akademike, shkencore etj.

"Gjeometria deskriptive dhe procesi i transformimit të aksometrisë në perspektivë" dhe "Leximi kritik dhe komunikimi dinamik i arkitekturës", ishin temat e ligjërates, ku para studentëve të Departamentit të Arkitekturës, në UBT, ka ligjëruar profesori nga Republika e Shqipërisë, Dr. Daniel Guralumi.

Studentët përveç që u ndan të kënaqur me ligjërimin e profesorit Guralumi, ata përfituan njohuri të reja nga fushë e arkitekturës.



PROF. SOUMITRA SHARMA, LIGJËROI PARA STUDENTËVE TË UBT-së

Prishtinë, 03 korrik 2012- "Current Economic Crisis" ishte ligjërata e radhës, për të cilën, para studentëve dhe stafit akademik vendor dhe ndërkombëtar të UBT-së, ligjëroi Prof. Soumitra Sharma, profesor i shquar i sektorit të ekonomisë në "Juraj Dobrila University of Pula" dhe në "University of Zagreb" në Kroaci.

Prof. Sharma, gjatë ligjërates së tij tha: "Flitet se ka krizë të madhe ekonomike në nivel botëror, por nuk është ashtu, sepse kjo krizë ka kapluar vetëm ato shtete që nuk kanë ditë të menaxhohjës vendet e tyre". Ai më tej foli për rastin e Greqisë, se si është futur në një krizë të thellë ekonomike, dhe se si shtetet tjera të Evropës po e ndjekin rrugën e saj si Italia, Franca, Spanja etj.

Po ashtu sipas profesori, dhe matjeve të tij profesionale kjo krizë pritet të kalojë në vitin 2017.

Në debat, përveç studentëve dhe profesorëve të UBT-së, morën pjesë edhe personalitete të shquara nga fushat e ekonomisë, shkencës, etj.



MASHT DHE UNIVERSITETI I SHEFFIELD NDAU BURSË PËR STUDIME TË DOKTORATËS PËR STAF TË UBT-së

Prishtinë, 22 tetor 2012- Can. dr. Fatbardha Qehaja-Osmani, ka fituar bursë të plotë për vazhdimin studimeve të doktoratës nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Republikën e Kosovës dhe Universiteti i Sheffield në Selanik të Greqisë. Më saktësisht në Fakultetin e Shkencave Shoqërore- Departamenti i Edukimit në Universitetin në fjalë.

Ndrryshe, Fatbardha është profesoreshë e rregullt në Universitetin UBT, dhe ligjëron lëndën e gjuhës angleze në tre module të ndryshme, për më shumë se shtatë vite.

Po ashtu, në një takim ministrin e arsimit, prof. dr. Ramë Bujë, uroj kandidaten për bursën e fituar dhe i uroj sukses dhe kontribut të mëtutjeshëm për vendin.

z. Fatbardha para se të angazhohet në UBT, ka punuar në disa organizata ndërkombëtare të akredituara në vend dhe në Kryeministrinë e Republikës së Kosovës.



STUDENTI I UBT-së, MASTERIN E PËRFUNDOI NË ANGLI

Prishtinë, 28 shtator 2012- Berati Thaqi, posa përfundoi studimet Master në Britani të Madhe, në Universitetin Staffordshire, në programin Economics for Business Analysis, kurse studimet themelore i patë përfunduar në UBT, në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.

"Në UBT pata vendosur të studioj për shkak të cilësisë së ligjëruesve, të cilët kanë qenë nga shtetet kryesisht nga Evropa dhe bota, dhe ligjërimi në gjuhën angleze, do ta përmendja profesorin Kim Serota, nga SHBA, që ka pas një qasje shumë praktike të ligjërimit të lëndës "Integrated Marketing Communication", tha B. Thaqi.

Ai më tej shtonë se, puna që bëhet në UBT është për tu vlerësua e sidomos në aspektin shkencorë, për arsye: se sjellja e stafit akademik nga vende e ndryshme, sigurisht që mundësia e zgjedhjes për dije është më e mëdha dhe më kualitative, dhe aq më tepër, që në vendet e zhvilluara, edukimi dhe përvojat e atyre profesorëve janë shumë më të pasura.



UBT vazhdon të ndërtohet ndër vite dhe kjo është diçka tejet e çmueshme për vendin tonë, gjë që ky institucion ka vazhduar ta mbajë cilësinë si qëllim të vetëm, dhe për këtë e ka vendin e merituar në Republikën e Kosovës dhe më gjerë, përfundoi B. Thaqi.

NGA UBT NË ITALI.... MË PAS NË EULEX



Ardian Isufi, ka diplomuar në Fakultetin Shkencë Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, kurse studimet mesatar i ka vazhduar jashtë vendit, më saktësisht në Republikën e Italisë, në Universitetin Politecnico di Milano. Ardian pas ka përfundimit të ligjëratave të Masterit, punësohet në Republikën e Kosovës, me detyrë Zhvillues i Softuerit në Misioni të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë - EULEX.

U PROMOVUA LIBRI SHKENCORË “SISTEMI NDËRKOMBËTAR I NJËSIVE-SI”

Prishtinë, 5 qershor 2012- Në hollin e UBT-së, u organizua promovimi i librit “SISTEMI NDËRKOMBËTAR I NJËSIVE-SI”, të autorit Prof. Dr. Sc. Skender Skenderi dhe Prof. Besnik Skenderi.

Përveç botuesit më saktësisht Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe Dekanit të Fakultetit të Mekatronikës Dr. Muzafer Shala, fjalë rasti mbajtën edhe recensentët e librit si Dr. Sc. Rashit Maliqi, prof. ordinar, Prof. Dr. Sc. Sylë Tahirsyla, si dhe përfaqësuesja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Teuta Ceku Luboteni, Këshilltare për Meteorologji në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

“Më konkretisht ky libër i ofron lexuesit si nxënësve të shkollës fillore ashtu edhe shkencëtarëve informacione burimore dhe të rëndësishme për tërë procesion e zhvillimit të sistemit ndërkombëtar të njësive prej fillimit e deri tek zhvillimet e fundit”, tha Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, njëherit edhe botuesi i këtij libri dhe shtoi se duke qenë që nga fillimi i angazhuar për të



prof. dr. Skender Skenderi

ndjekur zhvillimet e këtij sektori, shpresojmë që autori edhe në të ardhmen, si edhe deri më tani, do të vazhdojë të japë kontributin e tij duke dokumentuar dhe duke na dhënë edhe botime tjera nga kjo fushë, citoi Dr. Hajrizi.

Kurse, Dr. Sc. Rashit Maliqi, recensentë i librit “SISTEMI NDËRKOMBËTAR I NJËSIVE-SI”, tha se Profesor Skender Skenderi është një ndër fizikanët e parë që ka filluar punën si mësimdhënës të mbaj mësim në gjuhën shqipe në fakultet, është profesori i parë i cili filloi përpilimin e teksteve nga lëmia e fizikës në gjuhën shqipe dhe është kujdesur që studentëve tu krijoj kushte për mësim dhe që vlen ta citojmë se profesor Skenderi është autori më kontributdhënës për përpilimin e librave të fizikës në gjuhën shqipe në të gjitha niveleve e arsimit në vendin tonë. Z. Maliqi tha se teksti në fjalë është shkruar më një stil të

lehtë dhe të afër për lexuesin. Më tutje foli edhe për veprimtarinë kombëtare të profesorit Skenderi.

Kurse prof. Dr. Sylë Tahirsyla tha se “ Është mjaft i avancuar, i një niveli mjaft të lart serioziteti shkencor dhe përfshin më të rejtat shkencore nga lëmia e meteorologjisë që e dallon nga teksteve simotra dhe i preferohet të shfrytëzohen të gjithë lexuesit e shkencave natyrore , teknike dhe teknologjike”.

“Matja është një ndër veprimet më të hershme intelektuale të njeriut, përmes së cilës ai ka arritur të njeh botën për rreth vetës, të përshatet asaj e të shfrytëzohet atë për nevojat e veta”, tha përfaqësuesja të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Teuta Ceku Luboteni, Këshilltare për Meteorologji në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, duke shtuar se Ju si njohës i mirë i Sistemit Ndërkombëtar

SI dhe si njëri për nismëtarëve të meteorologjisë, më promovimin e këtij libri keni ofruar informata të duhura për përdorimin e njësive të duhura në marrje të duhura.

Kurse dr. Muzafer Shala, Dekan në Fakultetin e Mekatronikës, citoi se ne çdo ditë gjatë jetës sonë të përditshme i përdorim njësit matës, gjeja e parë kur të zgjohe mi nga gjumi në mëngjes sytë tanë shkojnë te ora e cila na e tregon kohën e që ne na mundësonit organizojmë punët tona ditore, nëse kemi për të shkuar ndokund për punë ne atëherë duhet ta dimë distancën e vendit të punës e cila i takon madhësisë fizike bazë e qe quhet gjatësia, dhe duke i kombinuar këto dy madhësi bazë fizike kohën dhe gjatësin e te cilat kanë njësinë SI koherente, ne mundemi me e llogarite se ne çfarë kohe mundemi me qenë ne vendin e punës. Prandaj gjate ditës ne i përdorim njësive nga sistemi SI e qe ne mënyrë perfekte autori na i ka sjelle ne librin Sistemi Ndërkombëtare i njësive SI, tha z. Shala.

“Mua me duhet te ndalem pak edhe te krijimi i një ambienti pozitiv të punës dhe të mësimi e që është njëra prej pesë synimeve strategjike që i ka Universiteti për Biznes dhe Teknologji i udhëhequr nga Prof. Dr. Edmond Hajrizi. Kjo ndërlihet me hapësirën të cilën UBT-ja u ofron edhe kuadrove më të hershme qe i kane udhëheq proceset në Kosovë më saktësisht keni qenë pedagog tanë, mirëpo edhe ne kuadrove te reja qe kemi vazhduar studimet ne Universitet e Evropës perëndimore dhe Universitet Amerikane”, përfudoi dr. Muzafer Shala.

“Në pranverën e vitit 1924 Hamit Zasella Skenderi kishte rrugëtuar për në Tiranë, me mjete

të veta, për çka kishte sakrifikuar edhe pasurinë familjare, duke shitur 15 krerë kafshë shtëpiak, për të blerë abetare dhe libra tjera shqipe për ti prurë e më pastaj shpërndarë ato nëpër komunën e Mitrovicës e më gjerë”, tha profesor, Skender Skenderi më saktësisht njëri ndër autorët i librit “SISTEMI NDËRKOMBËTAR I NJËSIVE-SI”. Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili ka kontribuar në vijën e mosshpërguljes e shqiptarëve nga Kosova për në Turqi, i cili në atë kohë kishte arritë që 24 familje nga Vushtrria ti ndalojë që mos të shkojnë në Turqi, në bashkëpunim me disa përfaqësues të Qeverisë së ish- Mbretit Ahmet Zogu.

Profesori përshëndeti përzemërsisht botuesin e librit, Prof. Dr. Edmond Hajrizin, si dhe mysafirët, dhe paralajmëroj se së shpejti do ta boton edhe një libër për deklarimet Kushtetuese të 2 Korrikut.

Në emër të studentëve të UBT-së dhe studentëve të Republikës së Kosovës, profesorin Skender Skenderi e përshëndeti kryetarja e Organizatës së Studentëve të UBT-së , Saranda Musliu.

Autori, Skender Skenderi, është doktor i shkencave të fizikës, dhe ka një numër të madh të hulumtimeve dhe publikimeve shkencore, deri më sot ka publikuar 6 tekste për shkollën fillore, 28 tekste për shkollën të mesme dhe 27 tekste universitare, 47 nga lamija e informatikës, 4 të ndryshme, gjithsej ka botuar 112 tekste shkencore. Po ashtu që të dy autorët e librit në fjalë janë profesor të rregullt në UBT.




U PUBLIKUA LIBRI SHKENCORË “MATEMATIKA PËR EKONOMISTË”

Prishtinë, 17 tetor 2012- Doli nga shtypi libri shkencorë “MATEMATIKA PËR EKONOMISTË”, të autorit Prof. Dr. Azir Jusfi, i cili është profesor në UBT, Dr. Kristaq Filipi dhe Prof. Xhevahir Beqiri. Recensentët e librit në fjalë janë: Dr. Alit Ibrahim, dhe Mr.sc. Elisabeta Koci.

Funksioni i këtij teksti është që të përgatis studentë me koncepte dhe teknika të ndryshme të cilat përdoren në zgjidhjen e problemeve ekonomike, tha Dr. Azir Jusfi. Ky libër përbënë dymbëdhjetë kapituj.

Lidhur me këtë Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi tha; shpresojmë që autorë edhe në të ardhmen, si edhe deri më tani, do të vazhdojnë të japë kontributin e tyre duke dokumentuar dhe duke na dhënë edhe botime tjera nga kjo fushë.

Shumë ekzemplarë nga ky libër i posapublikuar nga fusha e matematikës për ekonomistë vetëm tash tutje janë të renditur në Bibliotekën e UBT-së.



PASUROHET SEKTORI I DREJTËSISË NË UBT

Prishtinë, 24 korrik 2012- Jo vetëm menaxhmenti i lartë që ka kujdes dhe interesim të madh ndaj Bibliotekës së UBT, por edhe stafi akademik, të cilët thuaj çdo ditë sjellin dhe e furnizojnë këtë bibliotekë më tituj më të rinj të librave nga fushat e ndryshme shkencor.

Vlen të veçojmë se gjatë këtyre ditëve Prof. Dr. Zejnullah Gruda, nga biblioteka personale ka sjellë një numër të madh të titujve të librave nga fusha e drejtësisë në Bibliotekën e UBT-së.

Tash tutje, përveç departamenteve tjera, edhe studentët e Fakultetit Juridik në UBT, kanë literaturë të bollshme për studime më të thela dhe më efektive.

Biblioteka e UBT funksionon si pjesë e universitetit dhe posedon infrastrukturë ndërkombëtare në të gjithë hapësirën e punës dhe të shërbimeve.

Biblioteka është e furnizuar me libra në gjuhë të ndryshme ndërkombëtare. Publikimet që janë fituar zakonisht janë nga qendrat e mirënjohura

ndërkombëtare si Vienna University of Technology, Harvard University, Oslo University, Oakland University, Nice University, etj

Biblioteka e UBT-së studentëve të vet ju mundëson qasje direkte në e-Libra (libra elektronike) dhe artikuj online, që kanë karakter shkencor dhe akademik në fusha të ndryshme.



UBT BASHKËPUNON NGUSHTË ME KOMPANITË INDUSTRIALE DHE PRODHUESE

Prishtinë, 27 shtator 2012- Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka UBT, me kompanitë dhe fabrikat më profitabile në vend në Evropë dhe nëpër botë, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe drejtori i Fabrikës "MECATYP", Enver Haliti, zhvilluan një takim të rëndësishëm dhe nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi.

Më konkretisht, kjo marrëveshje parashihet mundësimin e bashkëpunimit në mes UBT dhe

fabrikës në fjalë, shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e hapësirave që studentët e UBT-së të realizojnë punën praktike në Fabrikën "MECATYP", për nevoja të studimeve dhe hulumtimeve shkencore.

Po ashtu UBT Fabrikës "MECATYP", i ofron trajnime dhe këshillime për zhvillimin e projekteve hulumtuese dhe profesionale e sidomos në aspektet ekonomike, teknologjike dhe sociale.

Po ashtu gjatë nënshkrimit u citua se do të zhvillohen edhe dhe takime tjera të shpeshta për të iniciuar projekte të përbashkëta dhe të rëndësishme në mes UBT-së dhe Fabrikës "MECATYP", theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Sipas palëve nënshkruese bashkëpunimi në mes UBT dhe Fabrikës "MECATYP" ka filluar edhe më herët dhe pohan se marrëveshja është incizuar nga të dy palët.



STUDENTI I UBT-së, ELBASAN MUSLIU, MENAXHER KRYESOR NË "EUROMETAL"

"Studentët e UBT-së janë të mirëseardhur për punë praktike në cilën do kohë. Do i mirëpresim dhe do u lëmë hapësirë të mjaftueshme sidomos studentëve të cilët i përkasin Fakultetit të Mekanikës dhe Biznesit", tha Elbasan Musliu, për gazetën "UBT News".



Fabrika prodhuese, furnizuese dhe e montimeve "EUROMETAL", ka arrit të zbusë papunësinë në Komunën e Ferizajt dhe më gjerë, e cila aktivitetin në objektin, në buzë të Magjistrale Prishtinë - Shkup në fshatin Babush i ri - Ferizaj. Kjo fabrikë ka punësuar mbi 70 punëtorë brenda dhe punëtorët tjerë në terren, të cilët janë të profiëve të ndryshme që janë profesionale për punën që e bëjnë si inxhinierë, ekonomistë, etj., dhe bashkërisht kanë bërë që kjo fabrikë të arrijë majat e sukseseve të kësaj lëmie ndër ne e më gjerë. Kualitetin e prodhimeve të kësaj kompanie e siguron kuadri profesional i specializuar i kohës, si dhe teknologjia më bashkëkohore nga vendet evropiane.

Kjo fabrikë në treg është prej vitit 1993, dhe prej këtij viti deri më sot në këtë kompani janë bërë investime të shumta dhe sot rangohet në radhën e fabrikave me renome ndërkombëtare, gjë që këtë e dëshmon me sigurimin e licencës për prodhimin e metaleve.

"Gjatë viteve të fundit dhe falë suksesit, ndërmarrja është zgjeruar kryesisht në reparte prod-

huese/ shërbyese për kryerjen e punëve me metale (llamarinë), furnizimin dhe montimin në objekte të ndryshme: banimi, industriale dhe afariste, mirëpo falë angazhimit të mirë dhe punës së palodhshme dhe profesionale, kompania ka arrit që çdo vit të pajiset me makineri të ndryshme, ku tash posedojmë vijat e profilimit të llamarinës dhe te konstruksioneve të çelika, më të përsosura në treg", tha Elbasan Musliu, studentë në UBT, dhe menaxher kryesor në fabrikën "EUROMETAL".

Njohurit e fituara në UBT, po i zbatoj në fabrikë

I cili shton se njohurit e fituar gjatë studimeve themelore në UBT, në fushën e menaxhimit nga profesorët e UBT-së, të cilët kanë dhënë kontribut të pakursyer gjatë gjithë kohës, po i zbatoj në menaxhimin e fabrikës. Studentët e UBT-së janë të mirëseardhur për punë praktike në cilën do kohë. Do i mirëpresim dhe do u lëmë hapësirë të mjaftueshme sidomos studentëve të cilët i përkasin Fakultetit të Mekanikës dhe Biznesit, thotë Elbasan Musliu.

Kjo fabrikë "EUROMETAL", si punë të veten e ka prodhimin, furnizimin dhe montimin, dhe në tregun vendorë dhe të jashtëm ofron si mbulesa të profiluara në tjegulle, trapezoidale dhe fallc të dyfishtë të cilat janë të certifikuar me ISO -standarde , prodhon si Fasada Sinusoide S20 dhe S10, të gjitha profilet për rigjips, ulluqe rrethore dhe këndore, ofron elementet përcjellëse nga llamarinat dhe projektojnë ventilim dhe klimatizim, konstruksione metalike dhje izolim të gypave dhe rezervuarëve mbitokësorë, bëjnë furnizimin dhe montimin e paneleve për mbulimin e kulmeve dhe veshjen e objekteve (fasadave). Furnizimi bëhet nga kompanitë me renome Evropiane, të gjitha produktet mund të jenë të plastifikuar, zinkuar, aluminit dhe të bakrit.

Fabrikë më teknologji të standardeve evropiane

"Në vitin 1996 me iniciativën dhe kapitalin e pronarit, nga Zvicra janë importuar makina të ndryshme për përpunimin e llamarinës dhe këtu edhe daton

themelimi i repartit të prodhimit .Meqenëse investimet në lokacionin e tanishëm kanë qenë tërësisht të reja dhe se investimet janë filluar nga pika "zero", vlerësohet se janë investuar vetëm në infrastrukturën e objekteve prodhuese dhe administrative si dhe investimi në pajisje e makineri (makina, vincura, kamion, automjete terreni, skeleri), mbi 800.000,00 . Investimet e natyrës së këtyllë janë bërë me kapital vetanak si dhe nga burimet e kredisë nga bankat komerciale në Kosovë Nëse bëjmë një rekapitullim të investimeve nga viti 2006 e deri më tani, investimet në objekte prodhuese, administrative dhe makineri, kalojnë shumën e 1.000.000,00 €, tha Musliu.

Është prezentë brenda dhe jashtë vendit

Më prodhimet që ka kjo fabrike furnizojnë pjesë të madhe të tregut të Kosovës, klientët tanë ekzistues kanë një shpërndarje hapësirore në tërë Kosovën. Jemi në kontakt të përditshëm me klientët tanë potencial dhe në vazhdimësi jemi të njoftuar për kërkesat e klientëve tanë.

Priten investime, punësim dhe prodhim

Po ta shikojmë si nga ana e jashtme dhe e brendshme të fabrikës në fjalë shihet që është bërë investim i madh. Numëri i punëtorëve do të shtohet dukshëm me finalizimin e fazës së dytë të investimeve. "Eurometal" është në vijim të ndërtimit edhe të një objekti të ri, punët janë në vijim e sipër dhe ky repart do të shërbejë për nevoja të prodhimit. Reparti i ri do të ketë hapësirë punuese të mbuluar me sipërfaqe prej 2400 m2. Shpresojm se në fund të vitit 2012 do të përfundohet, kurse investim në të ardhmen do të kemi për makinerit dhe për vijën e prodhimit në objektin e ri, përfundoi Elbasan Musliu.



PRESIDENTI I UBT-së ANËTAR I BORDIT TË AGJENCISË TË STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Në pesë vitet e ardhshme, Presidenti i UBT-së do të kontribuojë në zhvillimin e Statistikave të Kosovës, pasi ai është zgjedhur anëtar i Bordit të Agjencisë të Statistikave të Kosovës.

Bordi është Organi i cili i përgjigjet Kryeministrit të Kosovës. Përbëhet prej 13 anëtarëve dhe ka për qëllim të zhvillojë programe dhe politika për statistikën e Kosovës. Zgjedhja e Presidentit është bërë me vota.

NGA UBT-ja DALIN EKSPERTË TË MEKATRONIKËS NË KOSOVË


"Njohuritë e fituara gjatë studimeve në UBT, në Departamentin e Mekatronikës, më kanë shërbyer shumë në punë, pasi të gjitha punët që i kryej në fabrikë dhe makinën të cilën e kam ndërtuar, janë të ndërlidhura me literaturën dhe me praktikën, të cilën e kemi bërë dhe fituar gjatë studimeve. ka thënë Bardhi Zeka për "UBT News"

Prishtinë, 19 tetor 2012- Mekatronika filloi që të zbatohet qysh në shekullin e kaluar në vendet më të zhvilluar në botë. Tash kjo lëmi thuhet se ka përfshijë cep më cep tërë rruzullin tokësor. Kjo lëmi para tre viteve dhe për herë të parë ka nisur të zhvillohet edhe në shtetin më të ri në Evropë, në Republikën e Kosovës më konkretisht në Universitetin UBT.

Në fund të këtij viti akademik, katër studentë (studimet themelore: Kreshnik Ismajli, Bardhi Zeka, Granit Ramadani dhe master: Luan Mulaku) kanë diplomuar me nota të mira dhe në afat të rregullt.

"Mekatronika është çelës i zhvillimit të teknologjisë, është ndihmesë për ndërmarrjet prodhuese si private ashtu dhe publike, është ndihmesë për lehtësimin e punës për menaxherët e kompanive", ka thënë presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili ishte edhe mentor i temës së diplomës, të kandidatit Granit Ramadani, i cili diplomoi me temën "Menaxhimi i procesit të prodhimit në Fabrikën "Xella Kosova L.L.C."

Ndërkaq i diplomuari Ramadani ka bërë me dije se pjesën praktike e ka realizuar në fabrikën "Xella Kosova L.L.C.". "Aty kam analizuar procesin e prodhimit si dhe ia kam propozuar kompanisë tri ndryshime, të cilat do ta përmirësonin efikasitetin e procesit të prodhimit si: ndërtimi



i një reaktori të ri, automatizimin e procesit të paketimit dhe monitorimi 'online' i procesit të prodhimit. Duke marr parasysh njohuritë që i kam fituar për këtë lëmi dhe faktin që ky drejtim është i ri dhe ka mungesë të kuadrit të Mekatronikës, mendoj se ky drejtim ia vlen të zhvillohet edhe më shumë në aspektin edukativ. Besoj që ky drejtim do të duhet të mësohet edhe në të gjitha shkollat e mesme të larta teknike", ka deklaruar Ramadani.

Ndërkaq Kreshnik Ismajli, i cili ka diplomuar me temën "Menaxhimi i dokumenteve personale nëpërmjet komponentëve mekatronike - USB-Dokument", te Dr. Muzafere Shala, është shprehur se tema në të cilën ka diplomuar është e punuar me idenë e tij. "Me këtë ide isha edhe fitues i bursës 'IpkoFoundation', për vitin akade-



mik 2011/2012. Këtë temë do ta bëjë publike edhe në konferencën ICMER, të cilën e organizon UBT-ja gjatë muajit nëntor", ka theksuar Ismajli.

Studentët e UBT-së ndërtojnë makina

Në sistemet e ndryshme të njësive matëse, njësitë e madhësisë të njëjlojta (të natyrës së njëjtë) janë të shumta dhe secila ka emërtim të posaçëm dhe paraqet një vlerë të caktuar të asaj madhësie. Sistemet të atilla janë sistemi US (amerikan) dhe sistemi Imperial (anglez) i njësive. Vështirësitë e përdorimit të këtyre dy sistemeve qëndrojnë në faktin se për një madhësi të caktuar ka shumë njësiti të cilat në shumicën e rasteve paraqesin vlera decimale njëra ndaj tjetrës dhe kanë emërtime të cilat nuk mund të sistemohen në asnjë pikëpamje. Ndodh që njësia me të njëjtin emërtim gjendet si në sistemin US ashtu edhe në sistemin Imperial, kanë shpesh herë simbol të njëjtë por vlera numerike dalluese. P. sh. barela US ka vlerë tjetër nga vlera e barelës imperiale: 1 barelë (imperiale) = 36 gal (imperiale), ndërsa 1 barelë (US) = 42 gal (US). Ka raste kur njësia me të njëjtin emërtim shfaqet edhe në tri sisteme me vlera të ndryshme. Mos të flisim për rastin kur për një njësiti thuhet e shkruset se është njësiti e "peshës" e në fakt atë duhet nënkuptuar si njësiti të masës, çka shkakton lajthitje edhe të profesionistët (që nuk janë mësuar me këtë "gabim").

Njësiti bazë

Sistemi ndërkombëtar i njësive – Si është aprovuan më 1960. Si përmban shtatë madhësi dhe shtatë njësiti të cilat janë përkufizuar pavarësisht nga madhësitë tjera dhe kanë apo do të kenë standardet përkatës të cilat ruhen dhe mbrohen me ligje, rregulla apo standarde ndërkombëtare. Jemi në tranzitin e përkufizimit të ri të të gjitha njësive në pikëpamje formale, dhe për tri njësiti bazë edhe në pikëpamje esenciale. Kjo vlen sidomos për kilogramin, dhe menjoh se në botimin e gazetës së ardhme do ta kemi këtë përkufizim me standardin përkatës. Në figurën 1 shihen madhësitë bazë me emërtime, me njësiti bazë dhe me simbolet përkatës të madhësisë dhe njësive bazë. Si nuk është statik, ai pëson ndryshime vazhdimisht dhe në të njëjtin vit këtu bëhen dhe shpallen risi të mëdha apo të vogla.

Në këtë tabelë duhet të vëreni shtypjen e simboleve të madhësisë (me shkronja të **pjerrëta**). Përkundraz, simbolat e njësive shtypen në stilin e shkronjave të drejta saktësisht siç parasheh standardi i tyre.

Madhësia bazë		Njësia bazë	
Emri	Simboli	Emri	Simboli
gjatësia	<i>l, h etj.</i>	metër	m
masa	<i>m</i>	kilogram	kg
koha	<i>t</i>	sekondë	s
intensiteti i rrymës elektrike	<i>I, i</i>	amper	A
temperatura termodinamike	<i>T</i>	kelvin	K
sasia e lëndës	<i>n</i>	mol	mol
intensiteti i dritës	<i>I_e</i>	kandelë	cd

Fig. 1

Parashtesa SI për shumëfshia dhe nënfshia të njësive

Vendimi më i rëndësishëm në SI pa dyshim është marrëveshja ndërkombëtare për krijimin e parashtesave (prefiksave) ndërkombëtare për krijimin unik në tërë botën të emërtimeve të njësive të marrë në etapa të gjata kohore. Në tabelën në fig. 2 shihen 20 parashtesa për krijimin unik të shumëfshive (10 parashtesa) dhe për krijimin unik të nënfshive të njësive (10 parashtesa). Emërtimet e shumëfshive janë ndërtuar nga fjalë të vjetra greke dhe nënfshive nga fjalë të vjetra latine, me propozimin e Akademisë së Shkencave të Francës, për një sistem unik "**për të gjitha kohërat dhe për të gjithë popujt**", ka qenë slogani nga vitet e para të krijimit të idesë për një sistem gjithëpërfshirës.

Parashtesa SI zbatohet në simbolet e madhësisë SI koherente dhe në tri njësiti jashtë SI: litër (L), bar (bar) dhe elektronvolt – eV (shiko librin S. H. dhe Besnik Skenderi: Sistemi ndërkombëtar i njësive – SI, v. 2012, faqe 28). Simboli i parashtesës gjithmonë vihen përpara simbolit të madhësisë SI koherente të emërtuar posaçërisht, ngjithërisht me të, si p.sh. milivolt: mV, milimetër: mm, kilovat: kW, pikofarad pF etj.

Sipas kësaj tablele del se secila madhësi fizike mund të ketë 10 shumëfshia, 10 nënfshia dhe njësiti koherente SI që bëjnë 21 njësiti. Kjo është e vërtetë, por nuk ka nevojë për të gjitha madhësitë fizike që të plotësohet kjo mundësi. Për masën, gjatësinë, forcën, shtypjen, punën, nxehësinë apo energjinë e shumë madhësi tjera, kjo tabelë ka zbatim, bile edhe nuk i përfshin as për së afërmi mundësitë e përfshirjes në jetën e përditshme. Por, në praktikë, shumë madhësi nuk kanë nevojë për tërë spektrin e nënfshive apo shumëfshive nga tabela në fig. 2. Kjo për arsye se disa njësiti SI koherente janë aq të vogla sa që nuk kanë nevojë për nënfshia, apo disa të tjera, janë aq të mëdha sa që nuk kanë nevojë për nënfshia.

Parashtesat SI për shumëfshia të njësive			Parashtesat SI për nënfshia të njësive		
Faktor	Emri parashtesës	Simboli	Faktor	Emri parashtesës	Simboli
10 ¹	deka	da	10 ⁻¹	deci	d
10 ²	heкто	h	10 ⁻²	centi	c
10 ³	kilo	k	10 ⁻³	milli	m
10 ⁶	mega	M	10 ⁻⁶	micro	μ
10 ⁹	giga	G	10 ⁻⁹	nano	n
10 ¹²	tera	T	10 ⁻¹²	piko	p
10 ¹⁵	peeta	P	10 ⁻¹⁵	femto	f
10 ¹⁸	eksa	E	10 ⁻¹⁸	ato	a
10 ²¹	zeta	Z	10 ⁻²¹	zepto	z
10 ²⁴	jota	Y	10 ⁻²⁴	yocto	y

Fig. 2

P.sh. njësia SI koherente e kapacitetit të elektrikut është aq e madhe, sa që i tërë rruzulli tokësor si përqes elektrik nuk do të kishte vlerën e një faradi (F). Për këtë arsye, për madhësinë e kapacitetit elektrik përdoren nënfshia të njësive farad siç janë: milifaradi (1 mF = 10⁻³ F), mikrofaradi (1 μF = 10⁻⁶ F) apo nanofaradi (1 nF = 10⁻⁹ F), pikofaradi (1 pF = 10⁻¹² F) etj. Nga na tjetër, njësia SI koherente e shtypjes paskali (Pa) është aq e vogël, sa që rrallë përdoret, por në praktikë më shumë përdoren shumëfshiat e paskalit, si p.sh. kilopaskali (1 kPa = 10³ Pa), megapaskali (1 MPa = 10⁶ Pa) dhe gigapaskali (1 GPa = 10⁹ Pa). Sa i përket barometrave të shkallëzuar në milibar (simboli: mb), njësiti jashtë SI të lejuar për përdorim, lirishtë skala në mb mund të lexohet si të ishte në hektopaskal (simboli: hPa), pasi 1 mbar = 1 hPa. Kështu kalohet lehtë në njësiti SI jokoherente.

Shumëfshii i parë zmadhohet për faktorin deka (da) 10; nënfshii i parë zvogëlohet për faktorin deci (d) 10⁻¹, shumëfshii i dytë zmadhohet për faktorin hekto (h) 10², nënfshii i dytë zvogëlohet për faktorin centi (c) 10⁻², ndërsa të gjithë të tjerët zmadhohen me faktorin kilo (k) 10³ e koherente dhe tri madhësitë jashtë SI. Pra, një vlerë të matur në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë e shprehur më sipas vlerës së gjetur, të lexuar apo të logarituar në njësiti e shkallëzimit të pajsisjeve. Ajo vlerë do të tallejë vendin e vet në tabelën për shumëfshia apo nënfshia. Nëse jo, do të përcaktoni vet se në mes cilave vlera ndodhet dhe e shprehni në atë njësiti apo shumëfshii që është më afër vlerës së gjetur. P.sh. keni gjetur vlerën e shtypjes së një gazi të mbyllur p = 178450,734 hPa. Sipas rregullit këtë duhet shkruar në tri shifra e plota të kësaj vlera, ndërsa pjesa tjetër shprehet e fuqinë përkatëse. Në këtë rast kjo do të ishte, duke postaj presja dhjetore bartet për tre vende majtas ashtu që fitohet vlera: p = 178,450734 x 10³ hPa. Duke ditur se 1 hPa = 10² Pa, atëherë vlera e sipërme do të jetë: p = 178,450734 x 10³ x 10² Pa apo

$$p = 178,450734 \times 10^5 \text{ Pa} = 17,8450734 \times 10^6 \text{ Pa} = 17,8450734 \text{ MPa}, \text{ pasi, sipas tabelës së sipërme } 10^6 \text{ është mega (M) parashtesa SI së cilës i ngjitet simboli i njësive SI koherente të shtypjes që është paskali (Pa). Tash mund të vazhdojë përpunimi i rezultati të matur në sa decimale dëshironi ta merrni saktësinë. Në qoftë se pajtohni me numrin e dy decimaleve, atëherë bëhet përafërimi i rezultati sipas decimaleve së tretë e cila duhet lëshuar me të gjitha shifrat pas saj në rezultat, ashtu që rezultati i matjes në dy decimale në njësiti megapaskal do të jetë$$

$$p = 17,84 \text{ MPa.}$$

Në formimin e parashtesave SI, nga të gjitha njësiti SI koherente (22 njësiti) dhe njësive SI bazë (7 njësiti), përjashtim bëhet vetëm në njësiti SI bazë kilogram, për të cilën shumëfshiat dhe nënfshiat krijohen në bazë të gramit (g), ashtu që tabela e shumëfshive dhe nënfshive për masë do të jetë tabela në fig. 4:

Nënfshiat e gramit			Shumëfshiat e gramit		
Emri	Simboli	Vlera	Emri	Simboli	Vlera
decigram	dg	10 ⁻¹ g	dekagram	dag	10 ² g
centigram	cg	10 ⁻² g	hektogram	hg	10 ² g
miligram	mg	10 ⁻³ g	kilogram	kg	10 ³ g
mikrogram	μg	10 ⁻⁶ g	megagram	Mg	10 ⁶ g
nanogram	ng	10 ⁻⁹ g	gigagram	Gg	10 ⁹ g
pikogram	pg	10 ⁻¹² g	teragram	Tg	10 ¹² g
femtogram	fg	10 ⁻¹⁵ g	petagram	Pg	10 ¹⁵ g
atogram	ag	10 ⁻¹⁸ g	eksagram	Ag	10 ¹⁸ g
zeptogram	zg	10 ⁻²¹ g	zetagram	Zg	10 ²¹ g
joktogram	yg	10 ⁻²⁴ g	jotagram	Yg	10 ²⁴ g

Fig. 3

Shndërrimi(konvertimi) i njësive brenda njësive të njëjlojta

Po e zëmë se kemi madhësinë m = 25 g të cilën duhet shndërruar në njësiti kilogram (kg). Dihet se vlen barazimi: 1 000 g = 1 kg. Në qoftë se nga ky barazim gjejmë simbolin g, do të kemi këtë barazim:

$$1 = \frac{1 \text{ kg}}{1000 \text{ g}}$$

Në qoftë se barazimin m = 25 g e shumëzojmë me një në sasi nuk ndërron asgjë, por në cilësi, po, pasi tash barazimi do të ketë këtë pamje:

$$m = 25 \text{ g} \times 1 = 25 \text{ g} \times \frac{1 \text{ kg}}{1000 \text{ g}}$$

Shihet se njësia g thjeshtohet dhe mbetet shprehja e cila ka në vete njësiti kg. Kryhet veprimi me kujdes, në formulën e cilësisë (1 = ...) gjithmonë në emëruet shkruani njësiti që dëshironi ta fitoni (në rastin e sipërm njësiti kg), ndërsa në numëruet njësiti e dhënë të cilën dëshironi ta konvertoni (në rastin e më sipërm njësiti g), me qëllim që njësiti e dhënë të thjeshtohet. Shikoni shembullin tjetër si është eliminuar njësiti km (kilometër) në favor të njësiti m (metër) dhe njësiti h (orë) në favor të njësiti s (sekondë) në rastin e shpejtësisë v = 64 km/h e cila duhet të shprehet në njësiti metër për sekondë (m/s). Për ta eliminuar njësiti km shkruajmë barazimin cilësor:

$$1 = \frac{1000 \text{ m}}{1 \text{ km}} \text{ ndërsa për eliminimin e njësiti h shkruajmë barazimin cilësor } 1 = \frac{1 \text{ h}}{3600 \text{ s}}$$

$$v = 64 \frac{\text{km}}{\text{h}} = 64 \frac{\text{km}}{\text{h}} \times \frac{1000 \text{ m}}{1 \text{ km}} \times \frac{1 \text{ h}}{3600 \text{ s}} = 17,78 \frac{\text{m}}{\text{s}}$$

Kjo metodë vlen për nxënësit që kanë mësuar thyesat, për ata më të hershit, le të kujdesen prindërit e të mos bëhen horë para fëmijëve të vet (shaka!).

Njësi që s' janë askund, e gjenden gjithkund!

Jeta e përditshme na shtynë që të jemi praktikë e të qartë. Kështu krijohen njësi si pjesë e një rrethi, një sferë, një kub, një paralelepipedi, një kohë prej një ore apo një madhësi e caktuar çfarëdo homogjene e cila mund të ndahet në pjesë të barabarta të cilat marrin emërtime sipas madhësisë ndaj tërësisë (shiko fig. 4):

- një e katërta e tërësisë e cila si thyes është ¼ quhet **çerek** apo **kuartal** (përdoret për paraqitjen e pjesëve – afateve të një tërësie kohore; nga një herë quhet edhe **periuadhë**);
- dy të katërtat e tërësisë e cila si thyes është 2/4= 1/2 dhe quhet **gjysmë** ; 2 **çerek** apo 2 **kuartal**;
- tri të katërtat e tërësisë e cila si thyes është ¾ dhe paraqet 3 **çerek** apo 3 **kuartal** dhe katër të katërtat e tërësisë e cila si thyes është 4/4= 1dhe paraqet tërësinë e objektit.



Fig. 4

- a) Objekti është rreth:** njësiti e sipërme paraqesin kënde: 1 çerek paraqet këndin e drejtë 90°, 2 çerek paraqesin këndin e shtrirë 180°, 3 çerek paraqesin këndin 270° dhe 4 çerek apo një rreth paraqet këndin e plotë 360°.

- b) Objekti paraqet orën:** njësiti e sipërme paraqesin njësi të kohës në minuta: 1 çerek ore paraqet = 15 min, dy çerek ore paraqesin gjysmë ore = 30 min, 3 çerek ore paraqesin 45 min dhe 4 çerek paraqesin 1 orë = 60 min.

- c) Objekti paraqet bukën e furrës prej 1 kg:** njësiti janë pjesë të kilogramit: 1 çerek paraqet 250 g, 2 çerek paraqesin gjysmë buke 500 g, 3 çerek paraqesin 750 g dhe 4 çerek paraqesin 1000 g = 1 kg.

Shtypja e simboleve të madhësisë, njësive dhe parashtesave SI

Në përdorimin e SI-së vlejën standarde të shumta të cilat në përpikëri duhet të zbatohen. Një ndër to janë edhe rregullat e shtypjes së simboleve dhe stiletve të shkrimit sa u përket simboleve të madhësisë fizike, simboleve të njësive fizike dhe simboleve të parashtesave SI, si dhe pozicioni i tyre ndaj simbolit të njësiti në të cilën zbatohen.

- Emrat e njësive dhe të parashtesave të njësive decimale, në gjuhën shqipe, shkruhen sipas drejtshkrimi shqip;
- Emrat e njësive dhe të parashtesave të njësive decimale shkruhen me shtypjen me shkronja të drejta, si p.sh.
 - shenja e simbolit për metër, gjithmonë është e drejtë, e vogël sipas definicionit, m;
 - për disa simbole mund të përdoren simbole sipas marrëveshjes ndërkombëtare për gjatësi të ndryshme; simboli i njësiti shkallë e Celsiusit është simbol i përbërë °C;
 - të gjithë simbolat e njësive shkruhen sipas normave ndërkombëtare dhe nuk kanë shumë: p.sh. 2 kg, 5 m, 12 mL etj. Nuk mund të shkruhet simboli i kilogramit me "K" të madhe e "g" të vogël (Kg), por vetëm si: kg;
 - për litrin lejohej simboli "l" e vogël apo "L" e madhe;
 - simbolet e njësive shkruhen pa pikë në fund, me përjashtim kur ndodhen në fund të fjalisë;
 - simboli i parashtesës SI shkruhet ngjithërisht me simbolin e njësiti në të cilën aplikohet, si p.sh. kg, mm, hPa, MW etj.
 - në simbolet e njësive dhe të parashtesave SI nuk bëhen të përdoren kurrfarë shenjash apo shkurtësia pranë simboleve të tyre.

KEQMENAXHIMI I KOHËS

*Ju nuk mund ta ktheni pas kohën, vetëm orën mund ta kursdisni nga e para.
(Bonnie Prudden)*

Nëpërmjet këtij artikulli synohet të sensibilizohen menaxherët, personeli dhe gjithë tjerët më interes të veçantë për rendësin e menaxhimit të kohës. Keqmenaxhimi i kohës është një sëmundje e kohëve moderne me të cilën përballen menaxherët sot dhe në përgjithësi njerëzimi. Të mësuarit në mirëmenaxhimin e kohës krijojnë një avantazh konkurrues të menaxhereve ndaj të tjerëve në tregun e punës dhe më gjerë. Menaxhimi i kohës nuk konsiston në: "të bësh sa më shumë të mundesh, por të bësh gjëra që të lejojnë arritjen e objektivit" në organizatë.

Në mjaft raste mosmenaxhimi i mirë i kohës shkaktohen një situatë stresuese me të cilin përballen menaxherët e kohës moderne, në tregun e punës, dhe në vendin e punës ku punojnë kështu që një mirmenaxhim e përjashton edhe fenomenin të qajtur stres i cili shkakton edhe mos siguri të menaxherët dhe mos delegimi i mirë

i punëve të tjerët, dhe vie deri tek me e keqja humbja e vendit të punës, apo edhe të depresioni për arsye të asaj se disa menaxher (Individ) janë të informuar apo vetëdijuesuar për menaxhimin e kohës dhe nuk i japin prioritet që të zbatojnë atë fenomen e cila do të ju ndihmojë shumë në sukseset e vete personale dhe të organizatës.

Mosmenaxhimi i mirë i kohës përveç situatave të pakëndshme ndikon në cilësinë e jetës në punë në organizatë. Menaxhimi i kohës nuk është një çështje e menaxhimit të kohës. Qëllimi real i tij është kristalizimi i çështjeve prioritare. Koha është fikse. Gjenden 60 sekonda në një minute, 60 minuta në një ore dhe 24 orë në një ditë. Menaxhimi i kohës është një sindromë e mangësisë së prioriteteve të qarta

Ne këtë artikull do të japim edhe rendësin të veçantë edhe Delegimit që ndikon pozitivisht

në mirëmenaxhimin e kohës, duke e shmangur menaxherit nga shumë detyra dhe përgjegjësi të cilat mund të delegohen. Në mjaft kompani dhe organizata në Kosovë dhe Shqipëri nuk kuptohet nocioni delegim dhe situatat ku menaxherët e nivelit të lartë në vend që të harxhojnë kohën për planifikim dhe udhëheqje harxhojnë më shumë kohë për organizim dhe kontroll janë situatat më dominuese për organizata që të keni një funksionalitet më të mirëfilltë dhe më të qëndrueshëm. Fatmirësisht ka strategji të cilat mund të përdoren për të menaxhuar kohën tuaj në mënyrën më të mirë të mundshme duke kontrolluar dhe reduktuar stresin, por ju duhet të analizoni kohën tuaj dhe të mendoni të gjeni rrugët me të duhur për të ndryshuar përdorimin e kohës. Në strategjitë që rekomandohen për të menaxhuar kohën tuaj theksojmë:

Përcaktoni gjithmonë qëllimet tuaja sa më qartë të mundeni.

Analizoni përdorimin tuaj të kohës.
Nevojitet të keni gjithmonë një plan për të arritur qëllimet tuaja.
Analizoni planin e veprimit.

Si për fund, po e sjellim një shembull praktik se çka të sjell keqmenaxhimi i kohës dhe në fund të fundi rezultati nga ky shembull të bie aty ku ka qenë me parë, nga pika zero në pikën zero, duke mos ofruar fare produktivitet më të kohën e harxhuar për të kryer disa punë të mos i përfunduar as njëherë prej tyre :

"..... Një ditë një bujk i thotë të shoqes : "Nesër do të plugoj fushën".

Të nesërmen që në mëngjes doli për të lubrifikuar traktorin, por i mungonte vaji dhe shkoi në dyqan ta blejë. Rrugës u kujtua se nuk u kishte dhënë për të ngrënë derrave, u kthye drejt hambaarit për të marrë misrin. Duke parë thasët u kujtua se duhet të mbillte patatet. Duke shkuar për ti

mbjellë u kujtua se duhet të çonte disa dru në shtëpi. Por më parë duhet ti priste dhe e kishte lënë sëpatën në kotec. Duke shkuar për të marrë sëpatën takoi gruan që po ushqente zogjtë e cila e habitur i thotë "Mbarove se pluguari?"
"Mbarova?" bërtiti bujku "Unë as që kam filluar"



Nysret Osmanaj, vijon studimet Master, në Departamentin- Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi



SHOQATA MIQTË E AMERIKËS
MIQTË E BILL KLINTONIT

THE ASSOCIATION FRIENDS OF THE USA
FRIENDS OF PRESIDENT CLINTON

E THEMELUAR MË 4 KORRIK 2004

FOUNDED 4 JULY 2004

UBT DHE "MIQTË E AMERIKËS" ORGANIZOJNË KONFERENCË SHKENCORE PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Prishtinë, 31 tetor 2012 - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), në bashkëpunim me shoqatën "Miq të Amerikës", më 20 nëntor 2012, organizojnë konferencën shkencore me temën: « Roli i SHBA-ve, në shtetformimin e shqiptarëve », e cila do të mbahet duke filluar nga ora 10.00, në Universitetin UBT, në Prishtinë, dhe

mund të përcillet nga të gjithë të interesuarit.

Në Konferencën « Roli i SHBA-ve, në shtetformimin e shqiptarëve », e cila do të mbahet me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, do të marrin pjesë rreth 30 pjesëmarrës – nga fusha akademike dhe politike nga Republika e Kosovës të vendeve të regionit dhe më tej.

EDINA PRET TË HAPË NJË EKSPOZITË PERSONALE NË UBT



Edina Mamusha, studente në Departamentin e Arkitekturës në UBT, dhe me profesion piktoresh, e cila deri më tani ka pikturuar 50 piktura, si portrete dhe reportazhe. Gjatë këtij semestri Edina pret të hapë një ekspozitë personale në UBT.

DRITONI ME KLIP TË RI



Driton Murati, student në UBT, i cili njihet si "DJ amator", hip hop, techno, i cili brenda këtyre ditëve do të promovoj një klip të ri. Ai për "UBT News" thotë së më primarë i ka njëherë studimet se sa muzikën.



Pamje e studentëve të UBT-së

SPORT

ARIAN AGANI, RRËFEN PËR PJESËMARRJEN E TIJ NË LOJËRAT OLIMPIKE

Prishtinë, 10 tetor 2012- Kompania "Olympic Broadcasting Services" shpall konkurs për pozitën Video Logger, për t'u punësuar gjatë Lojërave Olimpikë 2012, të mbajtura gjatë muajit korrik dhe gushtit në Londër. Konkursi në fjalë ishte shpallur vetëm për studentët e Universitetit City, për shkak të prestigjit që ka ky universitet në nivel botëror.

Arian Agani, duke besuar në aftësitë e vat profesionale, që i ka fituar gjatë studimeve themelore në Universitetin UBT si dhe në Universitetin City, konkurron dhe përzgjidhet ndër 80 kandidatët konkurrentë nga ky universitet. "Ishte një nga përvojat më të mira të jetës time. Punoja me medime gjigante si BBC, CNN, EUROVISION dhe televizione të tjera nga Amerika, Australia, Kina etj. Me fjalë të tjera, ishte një ambient shumë kulturor dhe fitova përvojë të cilën nuk kam pasur mundësinë ta përjetoj më herët", tha Arian Agani.

Ai më tej shton se edhe takimi me atletët shqiptarë, "me të cilët kalova një pjesë të ditës, ishte kënaqësi". "Pasi mbarova punën në Lojërat Olimpikë më ofruan kontratën që të punoja edhe në Lojërat Paraolimpikë, të cilën e pranova me shumë dëshirë dhe vullnet, ku edhe këtu punova për dy javë me radhë gjatë muajit shtator".

Arian Agani, i cili dy vitet e para të studimeve i ka përfunduar në UBT, në Departamentin e Mekatronikës, kurse vitin e tretë e vazhdon dhe e përfundon në Universitetin City në Londër në Angli, përmes projektit "Erasmus Mundus", projekt i Bashkimit Evropian, ku Universiteti UBT ivetëm privat nga Kosova dhe rajoni që është përfituese e projektit në fjalë.



STUDENTI I UBT-së, KAMPIONI I SHQIPËRISË



Prishtinë, 16 tetor 2012- Herolind Nishevc, me karakter të fortë dhe me një mentalitet fitues, i cili po arrin të shkëlqej në sportin e karatesë dhe student i suksesshëm në UBT, në kampionatin shtetëror të karatesë të mbajtur në Tiranë, arriti të fitojë titullin e kampionit të Shqipërisë dhe me këtë mori të drejtën që t'i mbrojë ngjyrat e kësaj përfaqësuese në Kampionatin Botëror të Karatesë, i cili do të mbahet në Paris të Francës nga mesi i nëntorit.

Nishevc triumfoi në kategorinë -84 kg, në luftëra, duke mposhtur së pari Skender Jazon, më pas Ermal Haderbeaj, kurse në finale ishte më i mirë se Daniel Hajta. Nishevc është shpallur disa herë edhe kampion i Kosovës dhe është fitues i shumë turneve të ndryshme.

"Kjo garë ishte shumë e rëndësishme për arsye se, ai i cili siguron vendin e parë do të fitonte të drejtën e pjesëmarrjes në një kampionat botëror që është ëndërr për çdo sportist të karatesë", tha Nishevc. Ai shton se Shqipërinë e kamë përfaqësuar edhe më herët, gjithashtu zotëroj edhe pasaportën shqiptare, por tani do ta përfaqësoj në garën më të rëndësishme në karrierën time në Kampionatin Botëror në Paris me 21 nëntor.

Planet e tij janë që t'i përfundojë studimet dhe të diplomojë sa më shpejt dhe t'i sjell Kosovës dhe Shqipërisë sa më shumë medalje.

Menaxhmenti i UBT-së përveç tjerave Herolindin uron për titullin e fituar dhe i uron sukses të mëtejshme në Kampionatin Botëror të Karatesë, i cili do të mbahet në Paris të Francës.

ARRITA TA LIDHI WING TSUNIN KOSOVAR ME ATË BOTËROR

Wing Tsun Kung Fu-ja, është një shkathësi luftarake e përhapur në gjithë botën, është mjaft komplekse por shumë efikase, është një sport që e ushtrojnë të dy gjinitë, pra, edhe për femrat është i përshtatshëm, sepse prek butësisë dhe ashpërsinë. Këtë stil të Kung Fu-së, e ka ushtruar Brus Li (Bruce Lee).

Naser Ramadani, studentë në UBT, në Departamentin Shkenca Komputere dhe Inxhinieri, Master, që nga viti nga viti 1985, merret me sportin e Kung Fu stilit Wing Tsun (Wing Chun), Sistem i Leung Ting-ut, dhe i cili, për herë të parë këtë sport e ka sjellë në Kosovë, dhe gjatë kësaj periudhe bëhet mjeshër dhe instruktor i Kung fu-së, kurse më 1993, hap klubin e Kung fu-së Wing

Tsun "Prishtina" në Prishtinë, në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve, dhe mban ushtrime të rregullta, si trajner i Wing Tsun-it dhe Eskrima dhe Jeet Kune Do.

"Më parë kam ndjekur shumë seminare kryesisht nëpër Kroaci dhe në Gjermani në qendrën kryesore evropiane për Kung Fu EWTO, me mjeshër të mëdhenj botëror", tha ai.

Tani është instruktor dhe trajner kombëtar i Wing Tsun Kung Fu-së, përfaqësues për Kosovë i EWTO-së. Përndryshe ka edhe një karriere në Eskrima, Jeet Kune do, Karate, Xhudo, Aikido dhe një shumë elemente të stileve të ndryshme luftarake, më një fjalë ka një përvojë afër 30 vite ushtrime të rregullta.

"Mendon t'i zhvilloj Kung Fu-së në nivel më të lartë tu përfshi zgjerimin në qendra tjera nëpër Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Krijimi i një ekipi të mirë instruktorësh të cilët do të ishin në gjendje ta zhvillojnë më tutje këtë mjeshteri luftarake", tha Ramadani, duke shtuar se suksesi më i madh i tij ka qenë gjatë këtij viti që ka arrit ta lidhë sërish Wing Tsunin kosovar me atë botëror.

Qendra kryesore e kësaj federate është në Hong Kong (IWTO), ndërsa në Evropë është në Gjermani (EWTO), ku aty mbi 1800 shkolla të Kung fu-së, sot funksionojnë në kuadër të kësaj federate, e sa e sa tjera janë jashtë kësaj federate si të pavarura.



Përgatiti: Liridon Rafuna

ME NJË QËLLIM DREJT SUKSESIT!

Leonarda Emini dhe Florim Gashi njihen dhe shoqërohen si shokë të ngushtë dhe të shkëlqyer qysh nga shkolla e mesme "Teknike" "28 nëntori" - Dega Arkitekturës, në Prishtinë. Tani Leonarda dhe Florimi studiojnë në UBT, pikërisht në drejtimin Arkitekturë.

Ata u shprehën të kënaqur me kushtet që i ofron UBT-ja, por që normalisht duhet të pasur vullnet dhe përkushtim për të arritur atë që e kanë në cak. Pikërisht ata janë që i kushtojnë rëndësi më të madhe lëndëve profesionale në arkitekturë.

"Mënyra kolektive është shumë e rëndësishme për ta arritur qëllimin tonë, dhe ne kemi gjetur atë, kemi konsultime të kohë pas kohëshme për ata që na nevojitet, gjithashtu kemi edhe prezantime, që ndikojnë në notë por ndikojnë edhe tek ne, që të mësohemi me shumë, pasi që nesër do kemi punë të ndryshme dhe të jemi të gatshëm" tha Leonarda.

Ajo thonë se punimet në lëndët profesionale marrin më shumë kohë, por për neve është kënaqësi, sepse puna përfundimtare ta kënaq syrin, duke u dukur për të tjerët si një enigmë në vete.

"Projektet në lëndët semestrale janë shumë atraktive dhe gjithçka varet prej mësimdhënësit se sa të motivon për të vazhduar më tutje, por prapë nëse nuk i kushton rëndësi, qoftë edhe në mënyrë kolektive me koleg atëherë rezultatet do të mungojnë", citoi Florimi.

Këta të dy janë të hapur më të tjerët, bëjnë konsultime edhe me kolegë tjerë, bashkëpunojnë dhe i përkrahim ata që kanë nevojë.

Këta të dy kohën e lirë e kanë pak sa më të limituar, por gjithmonë e mundohem të kenë ndonjë aktivitet që të relakson, si muzikën, shëtitjet dhe leximin.

Nërsa Florimi është edhe gazetarë dhe kohën e lirë e gjen në hulumtime të shumta.

Leonarda dhe Florimi për fund thonë "Jeni vetvetja nëse doni të arrini, mendoni për atë që mendoni ta bëni, sepse po nuk e ditët se çfarë dëshironi të bëni ju nuk keni se çka të vazhdoni më tutje".



SA ËSHTË E MORALSHME ME PI DUHAN?

Derisa me ligj nuk ndalohet pirja e duhanit në ambiente të caktuara, duhan-pirësve pasiv nuk i mbetet gjë tjetër vetëm të shpresprijnë dhe të lutën që dëmi të jetë sa më i vogël.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (ËHO report on the Global Tobacco Epidemic, 2008, 2004), raporton se mbi 600,000 vdekje ndodhin çdo vit si pasojë e inhalimit nga duhan-pirja pasive, ku pjesa më e madhe e tyre fëmijëve, rreth 40 %. Definimi më i shpeshtë që përdoret për duhan-pirjen pasive është se "pirja pasive është inhalimi nga tymi i cigares pa vullnetin tonë i shkaktuar nga tjetri". Në të shumtën e rasteve, vdekja vjen si pasojë e sëmundjeve ku nga më të shpeshtat janë, kanceri në mushkëri apo edhe sëmundjeve të zemrës, sëmundjeve të frymëmarrjes, astmës etj. Në raportin e OBSH-së të vitit 2004, theksohet se në shumicën e rasteve të fëmijët kjo ka ndodhur në shtëpitë ku ata jetojnë.

Në këtë shkrim mundohem që duhan-pirjen pasive ta diskutoj për një këndvështrim moral.

Për secilin qytetarë që jeton në bashkësi, një prej parimeve ele-

mentare është kujdesi për të tjerët apo së paku mos dëmtimi me qëllim i qytetarëve tjerë. Ajo çka është në të drejtën e secilit nga ne është mënyra se si ne kemi vendosur apo duam të jetojmë. Kur një person i shkakton dëme tjetrit atëherë nuk ka të bëjë vetëm me të drejtën e tij por edhe me cenim të një të drejte tjetër, veprim që nuk është i pranishëm moralisht dhe mund të jetë i dënueshëm dhe i sanksionueshëm me ligj. Për fat të keq në Kosovë ende nuk diskutohet sa duhet kjo çështje edhe pse duhan-pirja është rregulluar me ligj, dhe tani është në proces edhe një projektligj i ri i cili pritet të miratohet në parlament. Derisa me ligj nuk ndalohet pirja e duhanit në ambiente të caktuara, duhan-pirësve pasiv nuk i mbetet gjë tjetër vetëm të shpresprijnë dhe të lutën që dëmi të jetë sa më i vogël. John Stuart Mill jep këtë shpjegim, se çka është e lejuar apo ku përfundon liria e secilit në veprimin e tij karshi të tjerëve. Qëllimi i vetëm kur mund të ushtrohet pushteti me të drejtë ndaj ndonjë anëtar të një komuniteti të civilizuar përkundëjt dëshirës së tij është për të mbrojtur të tjerët...". Në baze të këtij definicioni shumica e vendeve perëndimorë rregullojnë me ligj pirjen e duhanit, madje në disa

shtete është e ndaluar në vende publike nën moshën 18 vjeçare, dhe se për këtë mund edhe të pasojnë sanksionet, derisa për të tjerët përveç që konsiderohet si e dëmshme për shëndetin po ashtu shpesh i referohen si një ves që moralisht është i keq.

Te ky qytetarë ose ka mungesë morali ose mungesë besimi ndaj të mirës së të tjerëve!

Një numër i konsiderueshëm i atyre që merren me të drejtat apo liritë e individit në botë, kanë hedhur për diskutim çështjen se a mund të konsiderohet duhan-pirja pasive moralisht e keqe! Me të moralshme kam për qëllim atë veprim që është i bazuar në pasojë, pra në raportin shkak-pasojë. Raportet e OBSH-së tregojnë pikërisht këtë lidhje në mes të sëmundjeve dhe shfaqjes së përditshme nda tymi pa dëshirë tonë. Ajo çka shumica e qytetarëve kanë si preokupim të përditshëm është një përmirësim (ndryshim) i jetës së tyre në aspekt pozitiv. Secili qytetarë duhet të filloj ndryshimin pozitiv të jetës së tij duke filluar nga mundësit që ka, apo së paku mos ta dëmtoj tjetrin me secilin mun-

dësi që ligji ja mundëson apo në raste të veçanta edhe pse ligji ja ndalon të shfrytëzoj mos zbatimin e tij. Edhe pse ekziston mundësia që nuk janë të vetëdijshëm për dëmin që bëjnë, ajo që me së shumti mendoj se është ka të bëjë me mos respektin, që kemi për të tjerët dhe një lloj egoizmi i papërfillshëm që mbizotëron te kjo pjesë e qytetarëve. Te ky qytetarë ose ka mungesë morali ose mungesë besimi ndaj të mirës së të tjerëve. Po të ilustruohet me mirë dhe me thjeshtë mund të themi se ato mundësi për dëmtim të të tjerëve që i ka ato edhe i shfrytëzon, pra nuk ka një vetëdije që i shtyn të mendoj për të mirën e të tjerëve apo për të mirën e përgjithshme.

Pa një qytetarë të shëndetshëm nuk mund të ketë shtet të shëndetshëm. Një prej dëmtuesve më të mëdhenj të shëndetit është duhani dhe një numër i konsiderueshëm edhe i duhan-pirësve pasiv. Roli i shoqërisë civile dhe rëndësia që i kushtojnë është shumë e vogël, nuk mund të jetë më i rëndësishëm raportin mbi keqpërdorimin e veturave zyrtare sesa shëndeti i njeriut.

Edhe pse jo të gjithë qytetarët kanë të njëjtat prioritete nuk besoj se ka më të rëndësishme se jeta e njeriut apo jeta e shën-

detshme. Shoqëria civile dhe organizatat që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe liritë të njeriut duhet marr seriozisht edhe të drejtën e secilit për një ajër të pastër. Edhe pse e mira e secilit në të shumtën e rasteve është e lidhur me të mirën e të tjerëve p.sh nëse neglizhon shëndetin tënd apo e lëndon vetveten atëherë kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në familje, shoqëri apo edhe në vendin ku punon.

Mundësia që secili ti ndihmoj familjes në një vend të varfër si Kosova, do të jetë më e vogël. Kjo nuk mund të konsiderohet ndryshe veçse moralisht e keqe, e dëmshme për vetveten, për familjen dhe për rrethin ku jetojmë.

Media, shoqëria civile e ne veçanti institucionet që kane për baze shëndetin dhe të drejtat e njeriut duhet të marrin seriozisht këto raporte, dhe në baze të tyre edhe të avokojnë për politika që do të dalin në mbrojtje të kësaj pjesë të shoqërisë që helmohej çdo dite dhe në çdo ambient si publik e po ashtu edhe privat. Si mund ta vlerësojmë ndryshe një veprim se sa është i moralshëm përveç se me pasojat e tij.

Autori: Mr. Besmi Demi, studiimet Mastar i ka përfunduar në UBT, drejtimi Diplomaci

NEW TASTE MAX ENERGY



magnum

ENERGY DRINK
PIJE ENERGIJE

Produkt nga WILD Germany


EKSPOZITA TRADICIONALE UBT 2012

Prishtinë, 13 qershor 2012- Në lokalet e UBT-së në Prishtinë u hap Ekspozita tradicionale UBT 2012, në të cilën janë ekspozuar punimet e studentëve të Departamentit të Arkitekturës.

Të pranishëm në ceremoninë e hapjes së ekspozitës ishin studentë dhe profesorë vendorë e ndërkombëtarë, prindër, përfaqësues të institucioneve të vendit, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të tjera partnere të UBT-së, etj.

Ekspozita u shpall e hapur nga Drejtori për Çështje Akademike në UBT, Dr. Binak Beqaj dhe Kryetari i këshillit organizativ, Prof. Fatmir Krypa.

"Ekspozita në UBT është bërë tradicionale në çdo vit në muajin qershor të kemi të paraqitura punimet e studentëve tanë. Ky është një grumbullim i punës dhe përvojave të palodhshme të studentëve dhe të profesorëve që nënkupton shkëmbimin e përvo-



jave dhe njohurive për një temë të caktuar, dhe kjo që po shihet është puna njëvjeçare që është bërë nga studentët në bashkëpunim me profesorët e tyre", tha Dr. Binak Beqaj. "Arkitektët janë transparent dhe nuk kanë mun-

dësi që diplomën e tyre ta fusin në sirtarë, diploma e një arkitekti ka vlerë dhe shihet nga lagësia, nga aeroplani, si ndërtesat e banimit dhe objektet tjera të shumta që na rrethojnë", tha Prof. Krypa. Prof. Krypa, ju drejtua studentëve

duke ju thënë se, në bazë të kësaj ekspozite shihet se, puna e juaj është një garanci dhe tregon se jeni në rrugën e suksesit, dhe ju si krijues të rinj do të na përfaqësoni pandalshëm, jo vetëm në nivel lokal por edhe atë ndërkombëtar.

I pranishëm në ceremoninë e hapjes së ekspozitës ishte edhe Udhëheqësi i Zyrës për Aftësim dhe Arsim Privat në MASHT, Osman Shahini, i cili cekti se në Fakultetin Arkitekturës në UBT ka qasje serioze studimore, dhe pas përfundimit të studimeve, këta studentë do të marrin përgjegjësi për të qenë pjesë e ndërtimeve të shumta.

"Përgjithësisht kësi lloj ekspozita kemi të pakta nëpër institucione publike, kurse në institucione private studentët kanë mundësi më të shumta të shprehin talentin e tyre dhe të komunikoj me publikun, dhe ju apeloj që një metodë të tillë të të shprehurit ta ndjekin të gjitha institucione tjera studimore", tha z. Shahini.

Art Gashi, student i Fakultetit të Arkitekturës dhe i cili ka paraqitur një var punimesh personale, ndihet i privilegjuar meqë u ka dhënë mundësi të prezantojnë punën e vet para një audience profesional.

STUDENTJA E UBT-SË, GRIMERE DHE PRONARE E STUDIO "MAKEUP BY TESA"



Prishtinë, 22 tetor 2012- "Grimi filmik, teatral, 3d dhe grimi artistik në përgjithësi janë ato që më karakterizojnë në profesionin e grimerës", tha Tesa Gashi, e cila është studente në UBT.

"Grimi është pjesë e veçantë e artit për mua. Për këtë arsye kam hapur një studion "Makeup by Tesa", ku kohëve të fundit kam një fluks të madh të femrave nga

mosha 17 deri 50 vjeçare, e sidomos gjatë festave, siç është Halloween, Maskenballet, Vitin i Ri, Kërshëndellat etj. Po ashtu më vizitojnë edhe një numër i madh i meshkujve dhe femrave, që kërkojnë grim artistik dhe profesional për t'ju përshtatur kodit të dukjes në neja të ndryshme, por grimi filmik, teatral, 3d dhe grimi artistik në përgjithësi janë ato që më karakterizojnë në profesionin e

grimerës", thotë Tesa, për gazetën "UBT News".

Tesa edhe fotografe

Duke marrë parasysh gjithmonë rinin dhe temat tabu në vendin tonë, të gjitha fotografitë e mija i përshtaten një koncepti që si mesazh e kanë gjendjen aktuale të rinjve në botë", tha ajo. Duke shtuar se lloji i fotografisë është

Retro-Vintage, i cili lloj konsiderohet ndër më të mira, dhe pasqyron pozitivitet dhe qetësi emocionale në fotografi, dhe kjo e benë atë shumë të veçantë.

Ka një komunikim të gjerë me fotograf vendas dhe të huaj, ku përmes diskutimit rreth fotografisë, shpalljes së kreativitetit dhe informatave të nevojshme, përfiton më shumë njohuri. Është shu-

më domethënëse që të kesh një që të përkrahin në këtë drejtim.

Tesa hap ekspozitë

"Konkretisht, gjatë këtij semestri po planifikoj të hap një ekspozitë në UBT, të fotografikeve edhe makeup, përfundoi ajo. Tesa, ka edhe ueb faqen vet si : www.tesagashi.com.

Top Education for Top Students



10 vite Lider i Arsimit të Lartë

I certifikuar sipas Standardit ISO 9001 për cilësi

Përfytyes nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS

Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore

Kampion Evropian në Robotikë 2011

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Bartës privat i Arsimit të Lartë i akredituar nga Agjensioni për Akreditim dhe MASHT

Në bazë të Statutit dhe Vendimit të Këshillit Drejtues nr.835/45-12 të datës 12/06/2012 Kolegji UBT shpall:

KONKURS

Për vitin akademik 2012/2013 në këto programe studimi:

- MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (BA, MA)

Me mundësi specializimi:

- Financa, Banka dhe Kontabilitet,
- Marketing dhe Shitje,
- Manaxhment dhe Ndërmarrësi (MA)

- SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (BSc, MSc)

Me mundësi specializimi:

- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Softuer dhe Sisteme Inxhinierie,
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Dizajn dhe Multimedia
- Mekatronikë dhe Robotikë

- MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (BSc, MSc)

(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit, Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial, Ndërmarrësi dhe Menaxhment)

- ARKITEKTURË (BSc)

- JURIDIK (LLB)

- SISTEMET INFORMATIVE (BSc)

Përmes Kolegjit UBT ju mund të studioni dhe të përfitoni bursa studimi në Universitet partnere si:



City University London, Angli



Danube University Krems, Austri
Master in Business Administration (MBA)



CIFE (Centre International de Formation Europ.), Francë
Master in European Integration and Law (MA)



WIT(Waterford Institute of Technology), Irlandë
Master in Information Systems (MSc.)

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi 4X6

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta gjatë ditës.

Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që suksesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sisteme online
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Project, etc.

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik është 1200 €, me mundësi pagese deri në 12 kështe.

Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron zbritje 20-50%

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik



Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel: 038 541 400, Mob: 044 541 400, email: info@ubt-uni.net Apliko online: www.ubt-uni.net

Qendrat Rajonale për regjistrim dhe informim: Prizren, Gjakovë, Gjiilan, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Podujevë